



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.06.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi nën për nën i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Korab Lita, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Spartak Braho, Adriatik Alimadhi, Aurora Mara, Elena Xhina, Ediola Braha, Xhemal Qefalia dhe Ralf Gjoni.

Mungojnë:

Fatmir Xhafaj, Damian Gjiknuri, Alket Hyseni, Edmond Leka, Jurgis Çyrbja, Alban Zeneli, Andi Përmeti, Elda Hoti dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Edis Ibrahim - Këshilltar i Ministrit të Drejtësisë

Artan Syziu - Përgjegjës në Sektorin e Hartimit të Akteve në Ministrinë e Drejtësisë

Gianluigi Pratola – Ekspert Ndërkombëtar i Misionit EURALIUS

Edlira Osmani – Eksperte Vendase e Misionit EURALIUS

Marjana Papa - Këshilltare Ligjore e Misionit të OSBE-së

Kujtim Luli – Prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme

Ardian Nezha – Këshilltar i Avokatit të Popullit

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme, meqenëse plotësohet kuorumi.

Pika e parë e rendit të ditës: ju njoftoj se në Komisionin e Ligjeve është depozituar një kërkesë, e cila ka të bëjë me shkarkimin e Presidentit të Republikës. Bazuar në nenin 90, pika 2, të Kushtetutës dhe në nenin 112 të Rregullores së Kuvendit, një grup prej 55 deputetësh, me shkresën nr. 2502, datë 17.06.2019, kanë depozituar në Kuvend një kërkesë për shkarkimin e Presidentit të Republikës. Kjo kërkesë është protokolluar në Kuvend me nr. 2502/1 protokollit dhe dje i është njoftuar seancës plenare. Konform nenit 112 të Rregullores së Kuvendit, kjo shkresë i është njoftuar edhe Komisionit të Ligjeve.

Ditën e djeshme, në zbatim të Rregullores, unë, si kryetar i Komisionit të Ligjeve, ua kam vënë në dispozicion të gjithë kolegëve të Komisionit të Ligjeve kërkesën e arsyetuar të 55 deputetëve dhe, nga ky moment, në zbatim të nenit 112 të Rregullores, Komisioni i Ligjeve e ka futur në procedurë shqyrtimi këtë kërkesë.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi shqyrtimin nën për nen të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”. Komisioni ynë për këtë projektligj është komision përgjegjës. Relatore e këtij projektligji është kolegja Elena Xhina.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Drejtësisë, zoti Edis Ibrahimi, këshilltar i ministrit të Drejtësisë dhe zoti Artan Syziu, përgjegjës në Sektorin e Hartimit të Akteve. Nga misioni EURALIUS kemi të pranishëm zotin Gianluigi Pratola, ekspert ndërkombëtar dhe zonjën Edlira Osmani, eksperte vendase; nga misioni i OSBE-së është e pranishme zonja Marjana Papa këshilltare ligjore; nga Prokuroria e Përgjithshme është i pranishëm zoti Kujtim Luli, prokuror; nga Avokati i Popullit është i pranishëm zoti Ardian Nezha, këshilltar.

Siç jeni në dijeni, ne kemi kaluar një pjesë të paketës së ndryshimeve që propozohen në Kodin Penal, edhe kjo nismë e deputetëve.

Zonja Xhina, në mos gaboj e kemi lënë vazhdimin e shqyrtimit nën për nen të neni 14, që ndryshon nenin 274 “Prishja e rendit dhe e qetësisë publike”. Unë do të kërkoja, edhe për ekonomi kohe, që të fokusohemi tek ato nene, për të cilat ka dakordësi të plotë nga grupi i

punës, ndërsa neneve që i kemi lënë të hapura, do t'iu rikthehem përpara votimit të projektligjit në tërësi.

Atëherë, vazhdojmë me nenin 274.

Fjala është për ju zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Nenin 274 e miratuam herën e fundit dhe do të doja që të vazhdonim me dy nenet që i kemi lënë të hapura, që të jemi në rregull me procedurën.

Herën e fundit ne kemi lënë të hapura nenet 197 dhe 207, germa “c”. Unë kam bërë dy riformulime, të cilat ua kam vendosur përpara në tavolinë kolegëve dhe do të doja të fillonim me nenin 197. Kam bërë një ndryshim në titull dhe në përmbajtje “Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin”, gjë e cila u diskutua edhe në komision midis kolegëve. Riformulimi që unë kam bërë është: “Organizimi dhe ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit, në kundërshtim me ligjin dënohet me burgim nga 1 deri në 3 vjet. Po kjo vepër, kur në lojë lejohen të marrin pjesë personat nën moshën 18 vjeç, dënohet me burgim nga 2 deri në 5 vjet. Kur kjo vepër kryhet nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore apo në shërbim publik, që ka lidhje me veprimtarinë e lojërave të fatit, dënimi me burgim shtohet me ¼-ën e dënimit të dhënë”.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Sipas relatores, jemi rikthyer përsëri te neni 197, që është lënë i hapur dhe që ka të bëjë me organizmin e lojërave të fatit.

A ka ndonjë vërejtje për nenin 197?

Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Me sa shikoj, të tri paragrafët parashikojnë dënimin me burg, ndërkohë që ne nuk duhet të jemi kaq të ashpër. E para, ku do t'i çojmë se po bëhen shumë? Prandaj, unë propozoj që të fillojë me gjobë dhe më pas me burg. Nëse do të ketë të mitur nën 18 vjeç, dënohet me burgim...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë këtë vërejtje kisha, që duhet ta shtrëngojmë pak dorën në lidhje me burgimin.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja – A ka sugjerime?

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Në lidhje me pikën e dytë, në paragrafin ku thuhet: “ku në lojë lejohen”, besoj se këto fjalë duhen rregulluar, sepse nuk shkojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Për shembull, një version mund të jetë : “Kjo vepër kryhet nga personat nën moshë”.

Ulsi Manja – Pra, sugjerimi është për të gjetur një formulim të teknikës legjislative për fjalët “Po kjo vepër, kur në lojë lejohen...”

A ka sugjerime të tjera për nenin 197?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Lidhur me shqetësimin që ngriti kolegu Alimadhi, në fakt, ligji “Për lojërat e fatit” nuk lejon marrjen pjesë të personave nën moshën 18 vjeç dhe është detyrimi i administratorit të lojërave të fatit që t’i ndalojë dhe të mos i lejojë këta persona nën moshë që të marrin pjesë. Unë kam një pyetje për relatoren. Shikoj që në propozimin e bërë nga propozuesit për paragrafin e tretë thuhet: “Ndalimi që u bëhet personave që ushtrojnë funksione publike ose që kanë detyra...”. Te propozimi i nismës, siç është depozituar thuhet: “Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohet me një të katërtën”. Relatorja e ka ndryshuar këtë formulim dhe thotë: “Kur kjo vepër kryhet nga personi i ngarkuar me funksione shtetërore ose shërbim publik”. Mua më duket se propozimi i sjellë nga propozuesit është më i mirë, sepse mund të ndodhë që një person që ushtron një funksion shtetëror ose publik nuk organizon, por lejon, pra mbyll një sy dhe e mbështet për shkak të njohjeve, aferave korruptive e të tjera. Kjo është përgjegjësi e institucioneve, pra mund të jenë inspektorë të lojërave të fatit, punonjës policie e të tjerë, pra ata që e kanë për detyrë mund të korruptohen dhe të mbajnë një sy mbyllur ndaj dikujt tjetër që e ushtron këtë veprimtari. Pra, në këtë mënyrë ju e keni kufizuar shumë.

Ulsi Manja – Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit për sugjerimin!

Nga grupi i punës u pa e arsyeshme të bëhej ky formulim pasi, nëse do të ishim përpara rastit që zonja Hysi përmendi, do të ishim përpara shpërdorimit të detyrës dhe do të kishim një vepër tjetër penale. Pra, ky formulim u mendua të bëhej jo vetëm nga relatorja, por edhe nga grupi i punës, përfaqësuesit e Prokurorisë së Përgjithshme, të EURALIUS-it dhe të OSBE-së, megjithatë ne mund ta hedhim në votim.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Kam një pyetje. Me sa kam dijeni nga formulimi i mëparshëm i këtij neni, dënimi ishte parashikuar si për organizatorin e lojërave të fatit, ashtu dhe për lojtarët. Unë dua të kuptoj pse është hequr dënimi për lojtarët, çfarë ka ndodhur? A mund ta shpjegoni ju lutem?

Elena Xhina – Faleminderit, zoti Gjoni!

Në mbledhjen e kaluar të komisionit u diskutua lidhur me pjesëmarrësit në lojërat e fatit dhe propozimi i grupit të punës ishte që lojtarët të mos ishin subjekt të veprës penale, sepse nga fenomeni rezulton se, nëse lejohet që të organizohet dhe të ushtrohet veprimtaria e lojërave të fatit, lojtari që luan me 1 apo 2 mijë lekë të vjetër nuk ka faj. Në këto kushte nuk do të sillte asnjë gjë të re në penalizimin e fenomenit dhe në parandalimin e tij, sepse, nëse godasim organizuesit dhe ushtruesit, atëherë nuk do të kishim më pjesëmarrës. Pra, duhet të godasim fenomenin dhe jo viktimat e këtij fenomeni.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zoti Luli!

Kujtim Luli – Faleminderit!

Në lidhje me pyetjen që shtrohet, ligji në fuqi që po kërkohet të ndryshohet, pra neni 197, parashikon vetëm organizimin dhe nuk parashikon penalizimin e pjesëmarrësit në lojë për veprën penale. Pra, është e njëjta teknikë në kryerjen e kësaj vepre penale vetëm për organizuesit dhe ushtruesit e veprimtarisë, por jo për pjesëmarrësit në lojë.

Ulsi Manja – Po, zoti Fino!

Bashkim Fino – Unë nuk kuptoj një gjë edhe nga kjo që tha specialisti. Nëse organizimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së lojërave të fatit e kemi të ndaluar me ligj dhe dënohet me 3 vjet burg, atëherë çfarë do të thotë që personat që marrin pjesë nën moshën 18 vjeç dënohen 2 deri në 5 vjet burg. Çfarë kuptojmë me këtë? Kuptojmë që po u hapën lojërat e fatit nesër dhe lojtarët që janë nën 18 vjeç do të dënohen 2 deri në 5 vjet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, prisni se ky nen mund të mbyllet vetëm me paragrafin e parë ku thuhet: “Organizimi dhe ushtrimi i veprimtarisë së lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin do të dënohet deri në 3 vjet” dhe kaq, çdo pasojë tjetër që vjen nga personat nën 18 vjeç apo dikush tjetër, çfarë kuptimi ka kur ne me ligj e kemi të ndaluar. Pse t’u futemi ne çështjeve jo nën 18 apo 15 vjeç?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, ne, përderisa e ndalojmë me ligj, mendoj se një paragraf është i mjaftueshëm. Juristët mund të jenë më të zot, por kur ka 15 juristë, ka edhe 15 mendime.

Ulsi Manja – Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Falënderoj zotin Fino për sugjerimin dhe vërejtjen e tij. Meqenëse ligji është specifik, fëmijët nën moshën 18 vjeç nuk lejohen të luajnë në lojërat e fatit, pra është përgjegjësia e organizatorit, i cili ushtron veprimtarinë dhe që lejon të luajnë fëmijët. Pra, lojtarët nuk dënohen, por vetëm organizatorët që lejojnë fëmijët të luajnë. Kjo është bërë nga

deputetët nismëtarë, ku është menduar të ketë një masë mbrojtëse më tepër për fëmijët e mitur nën 18 vjeç.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Më thuaj nga se ka ardhur që ne po e heqim? Nëse ne i kemi hequr me ligj të gjitha lojërat e fatit, për mua një paragraf është i mjaftueshëm në Kodin Penal. Unë nuk e kuptoj këtë për lojërat e tjera, cilat janë këto lojëra?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, hape ligjin.

Ulsi Manja – Gjithsej janë 7 kategori lojërash fati që ka ligji “Për lojërat e fatit”, në mos gaboj ne kemi lejuar vetëm 3 dhe 4, të tjerat janë të ndaluara me ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Titulli i nenit propozohet: “Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin”. Pra, kjo fjali, nëse u referohet lojërave të fatit që nuk janë në kundërshtim me ligjin, nuk ka vend për këtë paragraf dhe jam dakord me zotin Fino, sepse si do ta verifikojmë ne pjesëmarrjen e fëmijëve apo të miturve nën moshën 18 vjeç në lojërat e fatit në kundërshtim me ligjin, ndërkohë që ju u referoheni lojërave të fatit që lejohen me ligj? Pra kjo mund të rregullohet me një fjali: “Në kundërshtim me ligjin dënohet me burgim nga 1 deri në 3 vjet”. Jam dakord edhe me zotin Braho, se do të mbushim burgjet dhe nuk do të ketë vende.

Ulsi Manja – Nuk është ky shqetësimi, se u kthjem përsëri te ky nen, ndërkohë që unë e kisha lënë t’i rikthehesha në fund, sepse e di se ky nen ka debate. Për bixhozin asnjëherë nuk gjendet ujdia. Po të ishte gjetur, nuk do të ishte ves, pra ka lindur bashkë me njeriun. Pra është e vështirë ta fusësh në kornizën e një dispozite të gjitha këto vese që ka njeriu. Elena, unë nuk e di përse më ktheve te ky nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 197 me rregullimet që keni bërë, duke hequr paragrafin e fundit, por edhe formulimi që kishte merak kolegu Alimadhi, më duket se ka qenë më i qartë në variantin e parë të projektligjit. Pra nga kjo vepër dënohen me burgim 2 deri në 5 vjet, nëse në lojë marrin pjesë persona nën moshën 18 vjeç, në variantin fillestar kjo del më e qartë, sesa në variantin që propozohet.

Ndryshimi i titullit nga “Organizimi i lojërave të fatit” në “Organizimi ose ushtrimi i veprimtarive të lojërave të fatit në kundërshtim me ligjin”, është i saktë.

Paragrafi i parë është në rregull.

Për paragrafin e dytë unë mendoj të merret varianti i parë, sepse është më i qartë. Fjalët “Kur në lojë marrin pjesë persona nën moshën 18 vjeç, dënohen me burgim nga 2 deri në 5 vjet” e komplikon pak përmbajtjen e dispozitës, ndërsa varianti “kjo vepër dënohet me burgim nga 2 deri në 5 vjet, nëse në lojë marrin pjesë persona nën moshën 18 vjeç” më duket formulim më korrekt. Pra, të hiqet paragrafi i fundit dhe mund t’i japim përgjigje edhe zotit Gjoni, i cili pyeti përse e keni hequr dënimin për personat që marrin pjesë në lojërat e fatit. “Paaftësia” e shtetit për të luftuar organizatorët ose ata që ushtrojnë veprimtari në kundërshtim me ligjin nuk do të thotë që të penalizosh përdoruesit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ai që e ka ves, nëse shikon një loto hapur, do të shkojë të luajë. Nëse doni të penalizojmë edhe ata që e luajnë, atëherë i bie që

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ralf Gjoni – Jam dakord me ju, sepse nuk më duket e kuptimtë që të penalizosh lojtarët. Ajo që dua të kuptoj është se përse në versionin fillestar, i propozuar nga ju këtu, ka qenë për të penalizuar lojtarët dhe rrugës u ndërrua, pra dua të kuptoj mekanizmin dhe arsyetimin përse u ndërrua.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Është shumë e thjeshtë, i nderuar koleg, sepse ky projektligj ka kaluar edhe në katër komisione të tjera për dhënie mendimi dhe sigurisht që Komisioni i Ligjeve është vendi ku një nismë politike, siç është iniciativa e një grupi deputetësh, vjen dhe formatizohet në një kornizë ligjore, sepse ky është komision ekspertësh dhe besoj se gjykimi ka qenë i drejtë.

Zoti Luli, urdhëroni, para se ta hedhim në votim!

Kujtim Luli – Në thelb, ajo që propozohet është e njëjta gjë, ndërsa në formë ndryshon. Nuk ka dispozitë në Kodin Penal që fillon: “Kjo vepër dënohet...”, pa shpjeguar për çfarë dënohet. Në aspektin teknik...

Ulsi Manja – Ti thua për aspektin e strukturës së dispozitës.

Kujtim Luli – Në aspektin e strukturës ta lëmë siç është, sepse nuk ndryshon asgjë.

Ulsi Manja – Dakord.

Nëse ju, si njerëz të praktikës, mendoni se është më elegante nga pikëpamja e teknikës legjislativë, e votojmë. Rëndësi ka të dalë qëllimi që duhet.

Po, zoti Braho.

Spartak Braho – I dashur kryetar, unë e kam parim që në llojet e dënimit të parashikohet edhe gjoba, ndaj e kërkoja. Nuk do të votoj asnjë dispozitë penale nëse dënimet

nuk vijnë në mënyrë alternative, nga gjoba te burgu. Nëse doni, vendosni edhe dënimin me vdekje ose tjetër, por e kam të ndarë mendjen që duhet të fillojmë nga dënimi me gjobë.

Ulsi Manja – Dakord.

E hedhim në votim.

Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Për procedurë, nëse e hedhim në votim propozimin e zotit Braho, të shikohet mundësia e gjobës, jo vetëm burg për çdo gjë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Unë po flas në emër të propozuesve dhe duhet të më kuptoni. Kur është propozuar kjo paketë, është thënë se në thelb do të ketë ashpërsimin e masave të dënimit për kategorinë e veprave penale që propozohen në këtë paketë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem!

Natyrisht, ka një propozim të kolegut Braho për ta filluar me gjobë.

Unë mund ta hedh në votim, pasi nuk ka asnjë problem, siç propozon kolegu Alimadhi.

Sipas Rregullores, hidhet në votim propozimi më i largët, më pas vihet në variantin e relatorëve.

Zoti Braho, do ta hedhim në votim.

Kush është dakord?

Spartak Braho – Meraku im është që ju, si jurist dhe punonjës i vjetër i sektorit, por edhe të tjerët këtu, të marrin vesh diçka nga politika e dënimit, e cila fillon nga më e lehta te më e rënda. Unë nuk fitoj me votim dhe nuk kam merak të dal ...

Ulsi Manja – Dakord, por qëllimi i paketës ka qenë ashpërsimi i masave të dënimit. Këtë gjë nuk po e themi sot. Ky është qëllimi i këtij neni.

Spartak Braho – Qëllimi i politikës së dënimit është të shpëtojmë njerëzit nga burgu, nga dënimet. Gjobë-burg, 3, 2, 1, 5, sa të doni, t'u japim një mundësi njerëzve që gabojnë. Për shembull, një person 18 vjeç e gjysmë do të shkojë direkt 5 vjet në burg.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po them mbi 18 vjeç, nuk po them ...

Ulsi Manja – Zoti Braho, qëllimi i ligjit është të dënojmë lojërat e fatit, sepse i kemi mbyllur. Pra, ata që marrin përsipër t'i organizojnë në kundërshtim me ligjin, të dënohen.

E dyta, të mos mbrojmë këta, që të mos shkojnë në burg, por të mbrojmë të tjerët, të cilët janë masa më e madhe e qytetarëve, që, normalisht, shkatërrojnë familjet duke iu drejtuar

lojërave të fatit dhe bixhozit. Ky është qëllimi, ndaj kemi mbajtur këtë qëndrim për politikën e dënimit.

Gjithsesi, nëse ju tërhiqeni, që unë të mos e hedh në votim, hedhim në votim nenin 197, sipas variantit që propozohet nga relatorja me riformulimet e bëra. Kush është pro? Kundër? 3 kundër. Abstenim?

Spartak Braho – Unë abstenoj.

Ulsi Manja - 1 abstenim.

Miratohet neni 197.

Zonja Xhina, të lutem, më ndiq.

Jo, nuk do të vazhdojmë me nenet që kemi lënë hapur, por me nenet që kemi në rrugë e sipër.

Kalojmë te paketa ku propozohen nenet për sportin.

Neni 15 i ligjit.

Për diskutimin e dy neneve kemi prezent në komision edhe kolegun Ylli, që është anëtar në Komisionin e Edukimit dhe Mjetet e Informimit Publik, që ka qenë komision për dhënie mendimi.

Neni 15 i projektligjit propozon që pas nenit 274 të shtohen nenet 274/a dhe 274/b.

Relatorja, zonja Xhina, urdhëroni!

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Në nenin 274/a nuk është bërë ndonjë ndryshim nga grupi i punës, përveç faktit që fjalët “mjedise sportive” janë bërë “ambiente sportive”, duke iu referuar ligjit për sportin.

Ndërkohë, nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ne kemi një propozim për këtë dispozitë, që paragrafi i dytë të ndahet në dy paragrafë të tjerë.

Ulsi Manja – Zoti Shameti, urdhëroni!

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë, meqenëse kam bërë prezantimin e paketës ligjore në Komisionin e Edukimit, në emër të grupit propozues të deputetëve, dua të sqaroj deputetët e Komisionit të Ligjeve se në Komisionin e Edukimit kemi pasur një diskutim shumë konstruktiv. Sikurse thuhet edhe në relacionin përfundimtar të mbledhjes ku u miratua kjo paketë, ka pasur edhe propozime shumë interesante.

Do të ftoja të gjithë kolegët e nderuar të Komisionit të Ligjeve, të dëgjojnë me vëmendje propozimin dhe gjetjet e zotit Ylli, i cili na ka nderuar sot me pjesëmarrjen e tij për t’i ezauruar ato, me qëllim që të bëjmë variantin më të mirë të mundshëm në këtë paketë ligjore për ndryshimet që kemi propozuar në Kodin Penal.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zoti Ylli.

Fidel Ylli – Faleminderit për fjalën, zoti kryetar!

Erdha në këtë komision, pasi kam qenë edhe pjesë e grupit të punës, të ngritur nga Kryeministri Rama, me të gjitha agjencitë ligjzbatuese për sa i përket dhunës nëpër stadione dhe në sport, pasi ishte futboll, që e detyroi, në njëfarë mase, Federatën e Futbollit dhe qeverinë të mbledheshin në një tavolinë të rrumbullakët për të diskutuar dhunën në futboll dhe në aktivitete sportive. Në këtë grup pune u vunë disa afate nga Kryeministri, që deri më 30 qershor ne duhet të dalim me një paketë të ligjeve për disa ndryshime në Kodin Penal. Unë kam bërë një kërkim parlamentar, duke i marrë të gjitha Kodet Penale të Europës, të gjitha ligjet e sportit, konventat europiane dhe kam një dosje shumë të madhe për të parë.

Në nenin 274 të Kodit të vjetër Penal, që kemi aktualisht, nuk thuhet asnjë fjalë për sa i përket dhunës në sport. Në nenin 274 flitet për prishje të qetësisë publike, për hedhje të gurëve dhe nuk thuhet asgjë më shumë. Megjithatë, unë mendoj se edhe grupi i punës i ka rënë pak shkurt, duke shtuar vetëm 2 nene, në një kohë që po të shikosh ligjet europiane, kryesisht unë kam këtu dy ligje, që ne pak a shumë u afrohem: ligji sloven, që është i gjithi i përkthyer; është edhe ligji hungarez, të cilin e referoi edhe Kryeministri si shembull për sa u përket ligjeve për sportin. Hungaria nuk ka vetëm një nen me dy germa “a” dhe “b”, por ka dispozita të veçanta në Kodin Penal. I ka kushtuar një rëndësi Kodit Penal për dhunën në sport dhe në aktivitete sportive. Duke lexuar atë me vëmendje, ne kemi bërë disa vërejtje, disa shtesa në këtë nen, ku theksojmë: “Nëse ka ardhur goditja ose veprat e tjera të dhunës ndaj sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv, për shkak të veprimtarive sportive, dënohet me burg nga 1-3 vjet”. Ne kemi bërë një shtesë: “Të kryera jashtë mjediseve sportive”, sepse po ta lëmë këtë nen kështu siç është, mund të fusim këtu edhe dhunën që mund të krijohet ndërmjet dy sportistëve në fushë, ndërmjet sportistit dhe gjyqtarit, ndërmjet gjyqtarit dhe sportistit dhe çdo javë u japim mundësi të dënojnë 3 ose 5 sportistë, në një kohë kur qëllimi nuk është ky. Federatat e Futbollit dhe federatat e tjera kanë gjykatat e tyre sportive dhe pjesën e lojës e kanë me komisionet e tyre të gjobave të ndryshme, të dënimeve deri në largimin nga fushat e futbollit përjetë. Ne kemi bërë një shtesë, ku thuhet: “Të kryera jashtë mjediseve sportive dënohet me burgim nga 1-3 vjet. Kur kjo vepër kryhet në mjediset sportive më shumë se një herë, apo është kryer nga drejtues, anëtarë të klubeve sportive, dënohet me burgim nga 1-5 vjet”. Nuk kemi pse e lejojmë një njeri që ta kryejë një herë atë vepër, të na sakatojë një gjyqtar apo një sportist në ambientet e sportit, që quhet edhe stadiumi brenda, por kemi shtuar: “Kur kjo vepër kryhet në mjediset sportive, dënohet me burgim nga 1-4 vjet”. E kemi hequr frazën

“kur e bën për herë të dytë”, por që në momentin e parë, kur e godet, kemi vënë një dënim. Kur kryhet në bashkëpunim, kemi vënë: “Kur drejtuesit apo anëtarët e klubeve sportive dënohen me burgim...”, pra kjo tregon kur stoli rezervë, siç ndodhi në Kamëz, ku presidenti, stafi drejtues futen dhe godasin në fushë arbitrin ose lojtarët, kemi vënë një dënim shumë të rëndë nga 1-5 vjet. Këto janë ndryshimet te neni 274, germa ” a”. Mendoj që këto t’i diskutojmë me anëtarët e komisionit.

Ulsi Manja - Për nenin 274, germa “a”, që të jemi të qartë, në titull “Goditja e sportistit, trajnerit, arbitrit dhe ndërmjetësit sportiv” nga komisioni përkatës, që është Komisioni për Edukimin dhe Sportin, ka një propozim, të cilin e prezantoi kolegu Fidel Ylli. Propozimin e kanë pasur në tavolinë relatorja dhe grupi i punës. Duke qenë se zoti Ylli është njeri i sportit, jam i bindur se ka qenë më i interesuar sesa ne për të kërkuar në këtë drejtim modelet më të mira që ka sot legjislacioni europian, por edhe ai rajonal në lidhje me dhunën në sport. A ka ndonjë koleg diçka në lidhje me propozimin e zotit Ylli?

Po, zoti Fino. Pastaj zonja Mara.

Bashkim Fino – Zoti Ylli, ne duam të bëjmë një Kod Penal të fortë për situatën brenda territorit të aktivitetit sportiv, qoftë ky futboll, basketboll, volejboll e të tjera. Jam plotësisht dakord me masat që merrni, dhe i keni vënë këtu, për goditjen e sportistëve, trajnerit e të tjera, por, kur thoni: “Kur kjo vepër është edhe jashtë ambienteve sportive”, kam përshtypjen se Kodi Penal në fuqi është i saktë. Mund të dal edhe unë në rrugë dhe të më godasë dikush, por unë bëj një denoncim dhe vazhdon Kodi Penal të respektohet. Problemi për mua është brenda territorit të një ambienti sportiv. Jashtë tij mund të jenë gjakrat e nxehta, siç shpreheni ju, por na del se edhe aktiviteti i një futbollit brenda ruhet me polici private. Jashtë policia thotë: “Unë marr përsipër se çfarë ndodh jashtë”, ruan tifozët e të tjera. Pra, jashtë funksionon policia, Kodi Penal. Cilësia e këtij neni dhe e masës së fortë është për brenda dhe unë jam dakord. Për jashtë, personalisht, kam një rezervë, pasi për jashtë ne kemi Kodin Penal në fuqi. Për çfarë do të ndodhë nesër jashtë bëhet një denoncim e të tjera me radhë. Ndërsa për shkak të aktivitetit sportiv, nëse ndodh dhunë brenda aktivitetit sportiv të fushës së basketbollit, volejbollit, futbollit, jam shumë dakord që Kodi Pena është forcuar dhe duhet të respektohet. Kështu të tjerët të kenë frikë dhe as t’u shkojë në mendje për t’u futur në fushë. Jashtë territorit të stadiumit jemi në publik të hapur, jemi në jetën normale. Kjo e fundit ka të tjera sanksione dhe ligje. Hajde ta ndajmë tani atë! Hajde ta ndajmë tani nëse u zunë përjashta për shkak të futbollit apo kishte një mëri të vjetër me dikë që pa atje! Atje ka një grumbullim të madh, që kanë parë një ndeshje e të tjera për shkak të aktivitetit sportiv. Unë jam plotësisht dakord me masat që vihen brenda. Jam dakord edhe për një gjë tjetër, i lexova

me kujdes nenet, ju thoni: “Për aktivitetet kombëtare 1-3 vjet dhe për aktivitetet ndërkombëtare 1-5 vjet”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për mua, aktiviteti njëloj është. Nëse ne do ta edukojmë vërtet qytetarin që të jetë korrekt, më mirë të jetë korrekt në një ndeshje të brendshme. Ndërsa për ndeshjet ndërkombëtare, nuk kemi pse t'i japim masën më të rëndë, në raport me një ndeshje kombëtare.

Ju e shikoni fare mirë se çfarë ka ndodhur me huliganët anglezë. Ndeshjet në *Premier League*-n angleze janë model, janë pa mbrojtëse në stadium e të tjera dhe e kanë futur këtë kulturë që në ndeshjet e tyre dhe nuk ka asnjë problem me kombëtaren, por nuk jam dakord që të ndryshojmë masën e dënimit, sepse është e njëjta vepër penale. Çfarë ndryshimi ka se luan Partizani me Tiranën apo Shqipëria me Francën? Për mua janë aktivitete të njëjta. Nuk kemi pse ta ndërrojmë, që, po u fut një person në një ndeshje ndërkombëtare, duhet të dënohet 5 vjet dhe po u fut në një ndeshje kombëtare që shkel ligjin dhe Kodin Penal, të dënohet 3 vjet.

Ulsi Manja - Po, zonja Mara. Pastaj zonja Hysi.

Aurora Mara - Faleminderit, zoti kryetar!

Për shprehjet: “Për shkak të veprimtarisë sportive” ose “Kur kryhet në mjediset sportive” duhet ta ndajmë mendjen të mbajmë ose njërën ose tjetrën, sepse çorientohemi. Ose do të mbajmë të parën, që është më e gjerë, ose do të mbajmë të dytën. Në të dyja rastet si në germën “a” si në germën “b”...

E dyta, dënimi me burgim nga 1 deri në 3 vjet mendoj se është i saktë për të dyja rastet, si kur kjo vepër penale kryhet në veprimtari sportive, si kur kjo vepër penale kryhet në mjediset sportive. Pra, vepra penale është e njëjtë, mund të mbajmë një dënim në të dyja rastet. Për shprehjet “për shkak të veprimtarisë sportive” apo “kur kryhet në mjediset sportive” duhet të ndajmë mendjen të mbajmë ose njërën ose tjetrën.

Ulsi Manja - Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Faleminderit, zoti kryetar!

Lexova propozimin e depozituar nga grupi i deputetëve, por edhe opinionin e sjellë nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Dëgjova me vëmendje kolegun Ylli, që parashtrroi këtë shqetësim.

Në fakt, neni 274, germa “a”, i parë në raport edhe me nenin 274, germa “b”, ka një mbivendosje, është ajo që tha zonja Mara. Besoj se veprat e tjera të dhunës ndaj sportistit,

trajnerit, arbitrit janë të dënueshme si brenda dhe jashtë mjediseve sportive. Pa dyshim, bëhet fjalë për shkak të veprimtarisë sportive dhe jo kur zihen për çështje të karakterit personal.

Te propozimi i riformuluar nga Komisioni i Edukimit shikoj se është hequr elementi i përsëritjes, ndërkohë zoti Ylli e tha disa herë, përsëritja.

E dyta, unë nuk shikoj as te neni 274/a, as te neni 274/b thirrje apo gjuhën e urrejtjes, thirrjet nacionaliste etj., që përdoren ndaj sportistëve, pavarësisht se ne kemi në Kodin Penal dy nene, 265 dhe 266, por aty thuhet “bërja e thirrjeve etj., etj.”. Lidhur me sportin, meqenëse ne kemi edhe një rekomandim të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës për t’i thënë “jo” gjuhës së urrejtjes në sporte, për të marrë masa enkas për gjuhën e urrejtjes në sport, sidomos racizëm, kjo ka gjetur rregullim.

Në këtë kuadër mendoj që neni 274/a dhe 274/b mund të rishikohen më mirë për të mos bërë një mbivendosje, pra “të ndëshkohet goditja dhe veprat e tjera të dhunës ndaj sportistit, trajnerit, arbitrit apo ndërmjetësit sportiv të kryera brenda ose jashtë mjediseve për shkak të veprimtarisë”. Pajtohem me propozimin e kolegut Fino, që ne nuk duhet të bëjmë dallim nëse ndeshjet janë kombëtare apo ndërkombëtare, të krijojmë pabarazi, pra ndeshjet janë ndeshje, goditjet apo çdo veprim dhune apo gjuhë urrejtjeje është e dënueshme, pavarësisht ndaj kujt adresohet, ndërkohë që mund të ishte vepër me rrethana më të cilësuar rast kur kjo vepër kryhet në mjedise nga drejtues ose anëtarë të klubeve, brenda dhe jashtë mjediseve sportive, s’ka rëndësi. Ai mund të qëllojë drejtuesit brenda mjedisit, por mund të qëllojë edhe në autobus, sapo kanë dalë nga ndeshja. Pra, rëndësi ka subjekti. Kush e bën veprën të cilësuar, subjekti apo vendi? Unë mendoj që e bën subjekti.

Nga ana e teknikës legislative do të sugjeroja që neni për veprën penale të mos jetë me dy paragrafë, por të jetë me tre, duke dalë në mënyrë të veçantë fakti kur ajo kryhet nga drejtues ose anëtarë të klubeve sportive.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Me aq sa arrij të kuptoj nga propozimet e kolegut Ylli, është që mënyra se si është formuluar 274/a të lë të kuptosh se do të ndëshkohen penalisht edhe kur sportistët goditen me njëri-tjetrin në fushë, edhe kur sportisti godet arbitrin në fushë. Zoti Ylli thotë që në të gjitha manualët sportive ndërkombëtare sot këto gjeste antisportive nuk dënohen penalisht, sepse ka ndëshkime që i bën vetë federata, e cila i përjashton përjetësisht apo përkohësisht nga futbolli. Pra, ka strukturat e veta FIFA dhe UEFA, kanë rregulloret dhe manualët e veta. Shqetësimi ka qenë ky që në mënyrën se si është formuluar paragrafi i parë i nenit 274/a, lë të kuptosh se penalizohet. Ideja është për të gjetur formulimin e saktë, sepse qëllimi është i përbashkët, që të

ndëshkojmë dhunën brenda vijave të bardha, por edhe në mjediset sportive, jo të futemi në gjërat që i ndëshkon vetë rregullorja sportive.

Këtë shqetësim shoh unë në atë që propozon kolegu Ylli.

A kemi mënyrë për ta riformuluar nenin 274, duke marrë në konsideratë edhe rregulloret sportive ndërkombëtare?

Urdhëroni, zoti Ylli!

Fidel Ylli – Ju formulojeni si të doni. Unë ju vë në dispozicion të gjitha kodet, që në rast se në kampionatin botëror Zidani e goditi në gjoks Kielinin dhe ky ra në tokë, ky rast nuk është vepër penale. Këto janë dënime me gjoba të rënda, dënime me përjashtime nga ndeshjet me javë, me muaj, me vite, por edhe me përjashtime nga futbolli.

Arsyeja pse e kemi ndarë këtë është se e kemi vënë jashtë fushës, mjedisit sportiv, ky është qëllimi. Pra, nuk e lë UEFA as policinë të futet në fushë, sado që federata e futbollit e kërkon këtë, prandaj ne nuk duhet të punojmë me dy standarde. Ne do të shkojmë me standardet e Europës, me standardet e institucioneve ndërkombëtare. Në fushë nuk lejohet të hyjë policia dhe ne kemi qëllim ta kthejmë sportin në një instrument, ku njerëzit të çlirojnë adrenalinë dhe të vijnë të kënaqen, prandaj kemi menduar që fushën t’ia lëmë federatës dhe të gjitha institucioneve ndërkombëtare që i kanë të përcaktuara në rregulloret e tyre dhe udhëzimet që kanë (se çdo aktivitet ka udhëzimin e vet) dhe nëse del lojtari nga jashtë stadiumit e godet, ajo është për shkak të detyrës.

Ky ka qenë qëllimi ynë, të ndajmë fushën nga ambientet jashtë fushës që të kemi mundësi që kur një tifoz që futet në fushë, e kemi përcaktuar ne këtu se sa dënohet. Edhe një pjesëtar i stolit, në rast se futet në fushë, ia kemi vënë 5 vjet burg. Pra, janë ashpërsuar dënimet, por normalisht duhet të heqim këtë, se ne mund t’i japim mundësi gjyqtarit të thotë që e godite arbitrin në fushë, e godite sportistin kundërshtar me grusht dhe do dënohesh 5 vjet burg. Nuk është ky qëllimi.

Në pikën tjetër, ku thuhet “në raste të përsëritura”, ne e kemi hequr dhe themi “jo”. Që në rastin e parë, nëse ti futesh në fushë dhe kryen akte dhune, do të shkosh para drejtësisë për të kryer një dënimin, 4 vjet. Ata që futen nga stoli i rezervave në fushë e kemi vënë më të ashpër dënimin, deri në 5 vjet burg.

Të gjitha këto janë marrë nga kodet penale ndërkombëtare, që i kemi përshtatur me kodin tonë. Shikojeni kodin hungarez, ka tri faqe vetëm për dhunën në sport! Jua vë në dispozicion. Unë nuk i jam referuar thjesht kodit të vjetër dhe i kam shpikur nga mendja. Keni një dosje këtu. Janë materiale me të cilat jam 3 muaj, me përkthime, me ligje.

Për sa i përket pikës për të cilën foli Vasilika (ligji i sporti nuk merret me Kodin Penal), në ligjin e sportit ne kemi vënë deri në 3 vjet burg nëse nxitet dhuna, racizmi, bindjet fetare e të tjera, duke iu referuar të gjitha ligjeve europiane.

Kam përkthyer ligjin e sportit në Republikën e Sllovenisë. Eksperti që ka futur Slloveninë në Europë ka certifikuar ligjin tonë të sportit, 4 vjet jemi marrë me këtë punë, kemi thirrur të gjitha grupet e interesit në Komisionin e Edukimit dhe s'kanë bërë asnjë vërejtje. Jemi marrë edhe me policinë, kurse tani del që Federata e Futbollit kërkon policinë në fushë. Po pse e do policinë në fushë? Se nuk kanë para të paguajnë policinë private? Jo, nuk është kështu. Ne më mirë ta mbyllim futbollin, ta bëjmë futboll amator (se edhe kryeministren e Anglisë, Theçerin, nuk e detyroi FIFA të mbyllë futbollin, por tha “stop”, do ta mbyllim futbollin për 7 vjet)...

Ulsi Manja – Ju lutem, se nuk do të mbyllim asgjë!

Këtu nuk ka futboll akoma. Le ta bëjmë një herë, e pastaj të shohim...

Fidel Ylli – Zoti kryetar, ne Kodin Penal nuk duhet ta lëmë vetëm me 3 nene. Ligji i sporti, Kodi Penal, Konventa Europiane duhet të detyrojnë të gjitha agjencitë ligjzbatuese të merren me një aktivitet sportiv, por mos t'ia lënë vetëm klubit të futbollit, se nuk ka kapacitete njerëzore klubi të merret me organizimin e një ndeshjeje, por të merren informacione paraprake për të parandaluar dhunën. Ne nuk kemi qëllim të dënojmë njerëzit.

A i kemi stadiumet me kamera, sipas ligjit? Jo. A i kemi stadiumet me standarde, kur ne në Shqipëri kemi vetëm dy stadione me standarde? Kemi stadiumin e Shkodrës dhe të Elbasanit, që janë në kategori të dytë. Të gjitha stadiumet janë jashtë standardit. Si të mos kesh dhunë?

Pra, nuk është vetëm Kodi Penal, është edhe ligji i sportit, edhe ligje të tjera që t'i detyrojnë klubet dhe federatën e futbollit të bëjnë stadione me standarde.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Mendoj të marrim një mendim nga eksperti ndërkombëtar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më fal!

Bashkim Fino – Këtu nuk është punë specialistësh sporti. Atë e the shumë mirë ti, le ta dëgjojë edhe Fideli, pavarësisht se diskuton me pasion, pasionin e tij kemi të drejtë ta vendosim në kod. Pse bëjmë ndryshime në Kodin Penal ne? Sepse në praktikë na kanë ndodhur disa gjëra jo të hijshme. Pra, ne nuk merremi me dënimet që bën federata, UEFA apo FIFA: sportist me sportist, sportist me trajner, sportist me arbitra e kështu me radhë. Jo, absolutisht.

Ne merremi me këtë sepse, bazuar në praktikën sonë, kanë hyrë njerëz nga stadiumi, qoftë të klubeve apo dhe sportdashës, dhe kanë goditur lojtarë, arbitra e kështu me radhë.

Këtë gjë po bëjmë ne në Kodin Penal. Po e ashpërsojmë Kodin Penal pikërisht për këtë gjë: që ata të kenë frikë të futen më, sepse përndryshe shkojnë në burg. Ose të skedohen, që të mos futen më stadiumet tona.

Në lidhje me këtë gjë, ne jemi dakord me Fidelin, ndaj duhet ta sanksionojmë fort dhe saktë. Kaq! Kështu, nuk ngatërrohet fare çështja e masave që ata marrin në aspektin sportiv. Se mund të ndodhë të zihen edhe lojtar me lojtar. S'ka punë fare. E tha shumë mirë ai: mund të mos ketë fare polici, sepse ai është aktivitet sportiv. Ne e forcojmë kodin për ata që hyjnë nga shkallët brenda në stadium, gjë që s' duhet ta bëjnë. Kaq! Kjo është arsyeja pse e forcojmë kodin dhe e bëjmë këtë nen.

Më pëlqen edhe kjo pjesa tjetër që ka bërë Fideli këtu, kur këtë dhunë e bëjnë stafet, të cilët duhet të jenë më të përmbytura, sepse e dinë rëndësinë e kësaj gjëje. Mund të mos e dimë që dikush hyn nga shkallët e stadiumit brenda, po kur këtë e bën trajneri, zëvendëstrajneri apo doktori i një ekipi kundër arbitrit, absolutisht ë masa do të jetë më e fortë. Prandaj mendoj se kjo është korrekte dhe e saktë. I vetmi diskutim që unë kam, por që e kam edhe si sugjerim për Fidelin, është se nuk duhet ta ngatërrojmë me çështjen jashtë stadiumit, sepse jashtë stadiumit është policia. Kështu është edhe në Wembley. Jashtë stadiumit është policia angleze. Brenda jo. Po dole jashtë stadiumit, nuk të falin ata. Po doli jashtë stadiumit, ai është qytetar i lirë, mbi të cilin vepron ligji, Kodi Penal, policia në rastin konkret, e cila natyrisht që do të jetë aty nëse ka grumbullime njerëzish. Nuk kemi pse ta ngatërrojmë me këtë gjë. Në qoftë se unë e respektoj ligjin, nuk futem në fushë për të dhunuar një arbitër, një gjyqtar apo një futbollist, ndërsa jashtë mund të ndodhë të ndeshen dy tifozëritë me njëra-tjetrën, për shkak të rezultatit. Ky rast nuk mund të ngatërrohet, se është tjetër gjë.

Pra, ne e ngremë dhe e forcojmë Kodin Penal pikërisht për këtë: që asnjë element të mos futet brenda në fushë, por aktiviteti të jetë si një teatër, ku shkohet për të kaluar një kohë të kënaqshme. Në lidhje me këtë gjë, mendoj se është rregulluar mirë. Le ta shikojë edhe një herë relatorja dhe le ta kalojmë, se nuk ka gjë, është vetëm për këtë, është vetëm për raste të kësaj natyre. Nuk ka të bëjë me grindjen mes lojtarëve, sepse kjo pastaj është punë e federatës, e UEFA-s.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Po, zonja Mara, se pastaj do t'ia kaloj fjalën zotit Luli.

Aurora Mara – Faleminderit, zoti kryetar. Shumë shkurt. Unë ngul këmbë në mendimin tim, se duhet të ndahet mendimi për shkak të veprimtarisë sportive, kur kryhet në

mjedise sportive. E para kjo. E dyta, në momentin që kjo vepër kryhet nga drejtues apo anëtarë të klubeve sportive, më duket pak e ekzagjeruar të dënohen më shumë. Vepra është e njëjtë, është vepër penale, është vepër e dhunshme, ndaj edhe dënimi duhet të jetë i njëjtë. Sepse, kështu, duket sikur i paragjykojmë drejtuesit dhe anëtarët e klubeve sportive.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fidel Ylli – Drejtuesi, i cili duhet të japin shembull e tij në aktivitet, se si duhet të edukohen sportistët, të futet e të godasë arbitrin me grusht?! Jo, duhet të jenë dënime maksimale. Ne kemi ardhur në një pikë, që i kemi stadiumet bosh. Pse? Për shkak të kësaj dhune, ndaj së cilës nuk merren masa, që futet shefi i klubit, i cili e mban arbitrin dhe presidenti i gjuan me grusht, ndërsa ne rrimë e heshtim, duam futboll. Ku ka futboll kështu?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Më falni! Zoti Gjoni, e më pas zoti Luli, për një mendim lidhur me formulimin e dispozitës.

Ralf Gjoni – Faleminderit, zoti Manja!

Unë jam dakord me zotin Ylli, që duhet ashpërsuar Kodi Penal për sa i përket dhunës që ushtrohet brenda mjediseve sportive. Besoj se i tërë neni 274/a duhet të riformulohet, duke marrë në konsideratë edhe shqetësimet e ngritura nga kolegu Fino, nga zonja Mara, por edhe nga zonja Hysi gjithashtu, sepse sportisti, në momentin që del nga stadiumi është qytetar i Republikës së Shqipërisë. Kodi Penal e ka parashikuar që policia duhet të bëjë punën e vet. Tani, sportisti ka edhe një jetë private. Si do ta përcaktojmë ne, nëse ai është në një moment dhune apo përplasjeje fizike me dikë jashtë stadiumit për arsye të disa faktorëve të tjerë personal, apo për shkak të ndonjë aktiviteti paralele? Një sportist ka edhe aktivitete të tjera biznesi, ka edhe inate personale, ka edhe hasmëri. Kësisoj, unë nuk besoj se në këtë moment Kodi Penal duhet të merret...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, e nxjerr hetimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, por unë besoj se të dy paragrafet mund të shkrihen midis tyre dhe të vendoset kur kryhet brenda mjediseve sportive, duke specifikuar që akti i dhunës bëhet nga një josportist, pra nga një tifoz a nga një person tjetër ndaj sportistit apo arbitrit. Unë besoj se, pavarësisht ligjit për sportin, duhet reflektuar edhe dhuna verbale, e cila është në nivele tejet të larta, pra fyerjet ndaj sportistëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E di, e di që e kemi, por duhet specifikuar. Unë mendoj se duke u shkrirë të dy paragrafët, kjo gjë mund të rregullohet. Ka nevojë për rregullim.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zoti Luli, në lidhje me nenin 274/a, ju lutem!

Kujtim Luli – Faleminderit, zoti kryetar!

Në lidhje me formulimin dhe subjektet e kësaj vepre, që nuk dalin qartë në paragrafin e parë, unë mendoj se pas togfjalëshit “për shkak të veprimtarive sportive”, të shtohet: “nga persona jashtë kësaj veprimtarie”. Pra, formulimi të mbetet siç është, dhe lidhur me subjektet, para se të fillojë pjesa ku fillojnë dënimet, të thuhet: “nga persona jashtë kësaj veprimtarie”.

Pra: “Goditja ose vepra të tjera të dhunshme ndaj sportistit, trajnerit, arbitrit, ndërmjetësit sportiv, për shkak të veprimtarisë sportive, nga persona jashtë kësaj veprimtarie, dënohet me burgim nga një deri në tre vjet. Ky është formulimi paragrafit të parë.

Ulsi Manja – Dhe e zgjidh plotësisht keqkuptimin që mund të lindte.

Kujtim Luli – Pastaj vijon paragrafi i dytë. Në vlerësimin tim bëhet fjalë për rrethana cilësuese, të cilat janë të pranishme te dhuna në sport. Fjalën “mjedise” ne e kemi propozuar në komision, dhe duhet bërë “ambiente”, jo “mjedise”. Janë ambiente sportive. Pra, fjala “mjedise” të kthehet në “ambiente”, ndërsa pjesa tjetër, më shumë se një herë, në vlerësimin tim duhet të jetë, sepse është një rrethanë cilësuese në gjithë teknikën legjislative të kodit. Nuk e rëndon, por e veçon një përsëritës në kryerjen e veprës penale, që të ndëshkohet më ashpër në raport me dikë që e kryen për herë të parë veprën. Pjesa tjetër pastaj janë subjekte të posaçme, ashtu siç janë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Pra, neni 274/a, në mënyrën si është propozuar nga nismëtarët. Unë bie dakord sepse, me sugjerimin e zotit Luli në paragrafin e parë të këtij neni, zgjidhet ai keqkuptim, për të cilin me të drejtë zoti Ylli thotë se ky paragraf nuk ka si qëllim të ndëshkojë lojtarët me lojtarët apo lojtarët me arbitrat. E gjithë dispozita, siç është formuluar, e nxjerr saktë në pah qëllimin që kanë pasur nismëtarët. E para merr në mbrojtje veprimtarinë sportive, ndërsa e dyta jep vendin si element të anës objektive.

Të dyja kanë pasur këtë qëllim: njëra të mbrojë veprimtarinë sportive si veprimtari, së bashku me subjektet që marrin pjesë në veprimtarinë sportive, ndërsa paragrafi i dytë i referohet vendit. Prandaj vendi është element cilësues këtu. Pra vendi, ambienti sportiv del më shumë se një herë. Unë jam dakord që të qëndrojë më shumë se një herë sepse, edhe në rast se herën e parë federata e ka përjashtuar për gjashtë muaj nga kompeticion sportiv, ndërsa ai, pas

rehabilitimit të masës administrative, i rikthehet prapë fushës së futbollit, ku kryen prapë po të njëjtën vepër penale, sigurisht që herën e dytë ai nuk do të dënohet më sipas masës një deri në tre vjet, por si përsëritës në kryerjen e kësaj vepre penale ai duhet të ndëshkohet më rëndë penalisht.

E dyta, shqetësimi që ngre kolegu Ylli, rasti kur dhuna ushtrohet nga drejtuesit apo anëtarët e klubeve sportive, gjen zgjidhje te paragrafi i dytë. Ajo që zoti Ylli propozon, është ndarja e paragrafit të dytë në dy paragrafe, ndërkohë që ne i kemi bashkuar në një. Pra, qëllimi ka qenë mjedisi sportiv, e ka edhe në propozim zoti Ylli dhe Komisioni i Edukimit dhe i Medieve, por edhe kur kryhet nga drejtues të klubeve. Ne i kemi bashkuar në një paragraf, i cili është paragrafi i dytë i nenit 274/a.

Unë propozoj që, duke marrë në konsideratë riformulimin e paragrafit të parë, të cilin e lexoi zoti Luli, ne të mos e prekim nenin 274/a.

Jam plotësisht dakord që te neni 274/b ka një propozim interesant, që lidhet edhe me gjestet antisportive, sharjet, fyerjet, që ngjallin panik, thirrjet raciste, gjuhën e urrejtjes... Jam dakord të diskutohet te neni 274/b, sepse shumica e konflikteve apo dhunës që ushtrohet në mjediset sportive i referohet gjuhës së urrejtjes. Pra, nga gjuha e urrejtjes kalohet në dhunë fizike e kështu me radhë.

Po, zoti Ylli. Na thoni diçka për nenin 274/a.

Fidel Ylli – Pse duhet ta tolerojmë një person, që kryen një vepër penale, mbasi sakaton një gjyqtar dhe t'i themi: “Hajde bëje edhe herën e dytë dhe shiko si do të të dënoj”? Pse? Që në momentin e parë që e kryen...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Fidel, të lutem!

E merr dënimin me burg...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I shtohet masa e dënimit.

Fidel, paragrafi i parë... Të lutem, më lër të të sqaroj, se kjo është nga pikëpamja e gjuhës juridike! Personi që ushtron dhunë ndaj sportistit, trajnerit, arbitrit dhe ndërmjetësit sportiv ndëshkohet penalisht që herën e parë, nga 1-3 vjet. Në rast se, pasi e vuan këtë dënim, ai vjen prapë në stadium dhe kryen të njëjtin veprim, do të dënohet nga 1-5 vjet. Kjo është normale, sepse është rrethanë rënduese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rëndohet më shumë. Në këtë kuptim është dispozita.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord me nenin 274/a, me sugjerimin që bëri zoti Luli?

Po, zoti Braho.

Spartak Braho - Po e ripërsëris, unë jam për dënime alternative, jo 2 vjet, 3 vjet, 10 vjet, por duhet të fillojë me dënim alternativ, duhet të fillojë me gjobë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

Zoti Fino, po e hedhim në votim.

Kush është dakord me nenin 274/a, me riformulimin e paragrafit të parë që bëri zoti Luli? Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 274/b, “Veprime të dhunshme në aktivitetet sportive”.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Te neni 274/b grupi i punës ka bërë disa ndryshime, duke nisur që nga renditja e paragrafëve, duke i kategorizuar sipas rrezikshmërisë së veprave.

Hyrjen në fushën e lojës e kemi ndarë në dy paragrafë, pasi kemi parë pasojën e ardhur dhe kemi vendosur një tjetër masë dënimi. Edhe nga Komisioni i Medies ka propozime për këtë dispozitë.

Duhet ta lexoj? Dakord, po e lexoj për qartësi: “Hyrja në fushën e lojës, gjatë kohës së zhvillimit të aktivitetit sportiv, nga persona të paautorizuar, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë. Kur nga kjo vepër ka ardhur pengimi i zhvillimit të aktivitetit normal të aktivitetit sportiv, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 muaj. Hedhja e sendeve të forta në fushën e lojës ose mbi masën e njerëzve (për përmbajtjen kemi diskutim nëse duhet apo jo element) apo përdorimi i lëndëve piroteknike, fishekzjarrëve dhe flakadanëve gjatë zhvillimit të një aktiviteti sportiv, dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 3 vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në aktivitete sportive ndërkombëtare, dënohet me burgim nga 1-5 vjet.”

Për sa i përket paragrafit të tretë, hedhja e sendeve të forta, komenti ynë është që masa e dënimit duhet të ulet.

Për sa i përket paragrafit të fundit, mendojmë se nuk duhet të jetë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Ulsi Manja – Ju lutem, ta mbarojë!

Elena Xhina – Për sa i përket paragrafit të hedhjes së sendeve mendojmë se duhet të ketë një masë më të ulët dënimi. Ne kemi propozuar nga 3 muaj deri në 2 vjet. Grupi i punës ka një variant.

Për sa i përket paragrafit të fundit, mendojmë se nuk duhet të jetë pjesë e dispozitës, por e lëmë për ta diskutuar në komision dhe ta vendosim.

Nga ana tjetër, zoti Ylli ka propozime të tjera, të sjella nga komisioni.

Ulsi Manja - Zoti Ylli dhe komisioni përkatës kanë një propozim për të shtuar një paragraf te neni 274/b, që lidhet me sjelljen antisportive dhe propozon një nen të ri, 274/c, me një përmbajtje tjetër. Do t'i diskutojmë të dyja, por të ndalemi pak te neni 274/b.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Mendoj se duhet të jemi pak më të saktë në këtë nen dhe në këtë paragraf. E lexova edhe këtë që tha relatorja, e respektoj edhe shtesën që ka sjellë zoti Ylli këtu.

Jam i mendimit të mos tallemi me këto gjëra, as me gjobë, as me punë me shërbim në komunitet ose me 3 vjet burg. Ne nuk kemi pse të bëjmë artificat tona. Ne mund të bëjmë një gjë që e ka bërë edhe bota. Në qoftë se një grup njerëzish kanë një sjellje të dukshme antisportive, të dhunshme, hedhin sende, shajnë, ritregojnë racizëm e të tjera me radhë, ka rregulla të tjera.

Është ajo që tha edhe Fideli, që stadiumet tona duhet të jenë model, me kamera e me të gjitha. Të evidentohen ata persona dhe të dënohen 3-5 vjet të mos shkelin në stadione.

E dini se çfarë do të thotë t'i thuash një sportdashësi që 3 apo 5 vjet nuk do të shkelësh në stadium? Ai është i skeduar dhe kur të vijë herën tjetër pastaj nuk do të marrë më atë masë, por 3 vjet burgim. Por duhet t'i hiqni këto “punë me shërbim në komunitet”, se janë tallje.

Fidel, unë jam i mendimit të futet masa e dënimit në ambientet sportive. Të dënohen personat të mos futet për 3-5 vjet në ambiente sportive. Këtë e ka gjithë bota.

Administrative, por të vendoset, sepse kështu ti e detyron tjetrin të thotë: “Ore, unë e bëra këtë gabim”. Ai është një njeri tifoz dhe e ndjek ekipin. E dini se çfarë do të thotë të rrijë 2 apo 3 vjet pa hyrë në stadium? Kështu e ka bërë edhe Anglia, kështu e kanë bërë edhe vendet e tjera.

Kjo është një masë ndërmjetëse, kryetar, midis asaj që ndodh para, duke hequr gjobën dhe punën me shërbim në komunitet, me pjesën e burgut. Po t'i dënosh njerëzit të mos vijnë 3 apo 5 vjet në stadium, të jesh i bindur që do ta minimizosh dhe nuk do ta zbatosh këtë dispozitë me 3 vjet burg për ata që hedhin sende të forta apo bëjnë sjellje të dukshme antisportive.

Unë mendoj se duhet rregulluar kjo dhe ky element duhet futur, se është shumë i rëndësishëm dhe e kanë të gjitha vendet... Le të jetë në kod. Pse të mos jetë? Ta paralajmërosh tjetrin. Ekipet ta paralajmërojnë grupin e tifozerisë së tyre që Kodi Penal është i tillë, që ti edhe mund të dënohesh. U filmove dhe dënohesh me mosfutje në stadium 3 vjet, 4 vjet, me emër, mbiemër, autografi e me të gjitha. Ne të gjithë tani jemi të certifikuar, me karta identiteti, shenja

gishtërinjsh, me fotografi, me të gjitha. Stadiumet të gjitha do të bëhen moderne dhe do t'u shërbejnë ndeshjeve ndërkombëtare. Do të jenë të identifikueshëm njerëzit, me kamera dhe me të gjitha.

Jam dakord edhe me atë që thotë ai, që dy stadione mund të jenë kështu, të tjerat jo, por ne do ta bëjmë në Kodin Penal sikur edhe ambientet sportive i kemi në nivel, se nuk mund të bëjmë një Kod Penal kështu...

Çfarë ndodh, zoti kryetar? Ta dëgjojë edhe Fideli këtë. Unë jam kundër dënimeve kolektive që bën Federata Shqiptare e Futbollit për 2,3 apo 5 individë në një ndeshje kombëtare. Në qoftë se 3 individë hedhin shashka apo diçka tjetër dhe thuhet: “Dënohet ekipi i Tiranës me 5 ndeshje pa tifozë”, çfarë është ky, dënim kolektiv? Jo, zotëri! Nëse në Kodin Penal është që ata persona identifikohen, ata 3 vetë merren, nxirren publikisht dhe thuhet: “Dënohen 3 vjet të mos hyjnë në stadium” dhe vazhdon tifozeria tjetër ta ndjekë ekipin. Por të dënosh në mënyrë kolektive dhe t’ia lëmë federatës këtë, është e gabuar. Këtë duhet ta marrë Kodi Penal dhe nuk duhet ta ketë federata.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Zoti Lita dhe më pas zoti Ylli.

Korab Lita – Faleminderit, zoti kryetar!

Jam dakord pikë për pikë me të që propozon zoti Fino. Është krejt normale ajo që propozon zoti Fino.

Kam edhe një propozim tjetër. Shoh se këtu ka dy standarde, për ndeshjet kombëtare dhe ndërkombëtare. Shkelja është e njëjtë. Pse duhet në një ndeshje...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Propozoj që këto të dyja të njësohen, sepse shkelja është e njëjtë, si në ndeshjet kombëtare, ashtu edhe në ato ndërkombëtare. Edhe dënimi duhet të jetë i njëjtë.

Për pjesën tjetër jam plotësisht dakord me dënimet alternative që dha zoti Fino.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Lita!

Zoti Ylli, do t’ju lutesha të flisni shumë shkurt, sepse kemi një orë që kemi ngelur me dy dispozita.

Fidel Ylli – E shpjegova që në fillim të herës, që ne nuk duhet të ngatërrojmë Kodin Penal me dënimet e Federatës dhe ato që ka ligji “Për sportet”. Unë po jua lexoj nenin 53 të ligjit “Për sportet”: “...ndalimi i hyrjes në mjediset sportive” dhe kemi dënime me gjobë që ndalojnë hyrjen në stadium 2 deri në 3 vjet, pra janë të përcaktuara në ligjin “Për sportet” masat administrative.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është histori tjetër, unë po them që ne e kemi parashikuar në ligjin “Për sportet” që të mos hyjë për 2-3 vjet, por qëllimi i këtyre masave në Kodin Penal është që ne t’i detyrojmë njerëzit siç i detyruam për vjedhjen e energjisë. Të gjithë shqiptarët vidhnin energji nëpër shtylla pa i dënuar njeri dhe ne u thamë “stop!”. Edhe këtu ne duhet të jemi të prerë që, për këdo që shkel vijën e kuqe në fushën e futbollit, dënimi maksimal është 3 vjet burg. Prandaj ta mendojnë mirë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, këtë e kemi me gjoba dhe jo me dënim me burg, e kemi zbatuar edhe me dënim me gjobë dhe nuk ka funksionuar. Duhet të marrim masa radikale në Kodin Penal kundër atyre që futen në fushë.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Fino, nuk është debat për këtë tavolinë, sepse Federatës i ka dalë nga duart kjo situatë dhe ne sot kemi ardhur të Kodi Penal, prandaj mua më intereson formulimi i dispozitës.

Zonja Hysi, keni fjalën.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Po ndjek me interes diskutimin që po bëhet në raportin e ligjit “Për sportet” dhe Kodin Penal. Një veprim apo një shkelje e rregullave që parashikohet në një ligj jo penal, si rregull parashikohet në Kodin Penal nëse personi, pasi ka marrë një masë administrative, e ripërsërit. Unë pajtohem deri diku me shqetësimin e zotit Ylli. Nëse hyrja në fushën e lojës gjatë zhvillimit të aktivitetit sportiv, është shkelje dhe dënohet nga ligji “Për sportet”, rimarrja e këtij përkufizimi nga ligji “Për sportet” dhe i futur në Kodin Penal pa thënë “pasi më parë ndaj tij janë aplikuar masat administrative” nuk është kushtetuese, çka do të thotë se nëse ju, zoti Ylli, jeni dakord, dhe këtu pajtohem edhe me atë që thotë disa herë zoti Fino, që ka një ligj të mirërregulluar, por nuk zbatohet nga padija apo injorohet, atëherë hyrja në fushën e lojës gjatë zhvillimit të aktivitetit sportiv nga persona ta paautorizuar, ndaj të cilëve më parë është zbatuar një masë administrative, dënohet me gjobë.

Në këtë kuadër bëjnë dallimin midis fuqisë së një ligji, që është jo penal dhe një ligji penal.

E dyta, ju flisni për propozimin që ka ardhur nga Komisioni i Medies. Po lexoj me vëmendje riformulimin ose shtesën që Komisioni i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik ka shtuar: “Komisioni i propozon komisionit tonë që, pas paragrafit të parë të këtij neni, të

shtohet paragrafi: "...sjellja e dukshme antisportive apo e dhunshme, që synon të nxisë alarm, panik dhe të përcjell zemërim””.

Pyetjen e parë e kam për zotin Ylli. Çfarë do të thotë sjellje e dukshme antisportive? Nga dallon sjellja e dhunshme nga të gjitha veprimet e tjera të dhunshme, që janë rregulluar në nenin 274, germa “a” dhe në nenin 274, germa “b” në paragrafët e tjerë? Ju e lidhni thjesht me nxitje alarmi, paniku dhe përcjellje zemërimi, por në rast se nuk e përcjell dhe një pjesë e tifozëve bashkohen, kjo nuk dënohet? Prandaj sugjeroj që riformulimi i sjellë nga Komisioni i Edukimit dhe Mjeteve të Informimit Publik për të shtuar këtë paragraf me këtë përmbajtje, të rishihet, sepse krijon shumë paqartësi dhe mbivendosje me disa rregulla të parashikuara në nenin 274, germa “a” dhe nenin 274, germa “b” në paragrafët përkatës. Kalojmë te pjesa tjetër dhe e kam pyetje për zotin Ylli.

Në propozimin e kolegëve deputetë thuhet se hedhja e sendeve të forta në fushën e lojës ose përdorimi i lëndëve piroteknike mbi sportdashësit, dënohet me burg nga 6 muaj deri në 3 vjet. Në ligjin për sportin a ka sanksione administrative nëse një sportdashës hedh sende të forta në fushën e lojës mbi njerëzit apo sportistët? Unë di që ka rregulla në ligjin “Për sportet” dhe këtu duhet të bëhet dallimi nëse personi është dënuar me parë me një masë administrative dhe ai përsëri ka kryer veprime të tilla?

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zoti Ylli, neni 274 germa “b” penalizon hedhjen e sendeve në fushën e lojës mbi masën e njerëzve, përdorimin e lëndëve piroteknike dhe hyrjen në fushën e lojës. A ka sanksione administrative ligji i sporteve për të dyja këto kategori?

Zoti Luli, a mund ta merrni ju fjalën?

Kujtim Luli – Në lidhje me nenin 274, germa “b”, ne e kemi diskutuar edhe në grupin e punës, kemi bërë riformulimin që paraqiti edhe relatorja dhe i kemi konsideruar si masa të nevojshme edhe për efektin parandalues të përgjithshëm që ka Kodi Penal në këto fenomene antisportive, të cilat kanë pasur problematika të shtuara këto vitet e fundit.

Në vlerësimin tonë kjo qëndron si dispozitë pavarësisht se mund të ketë gjobë administrative. Në rast të tillë ligji organik thotë që kur nuk përbën vepër penale përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë. Pra, është në vlerësimin e natyrës së gjestit antisportiv për ta vlerësuar nëse përbën vepër penale, apo është kundërvajtje administrative. Ndërsa paragrafi i dytë është një rrethanë më e cilësuar, sepse parashikon pengimin e zhvillimit normal të aktivitetit sportiv. Në vlerësimin tim është e nevojshme, sepse penalteti, kur ndërpret zhvillimin e aktivitetit sportiv, aplikohet edhe në fusha të tjera administrative, deri te gjoba e

fushës. Hedhja e sendeve të forta në fushën e lojës edhe kjo është një masë e duhur për shkak të fenomeneve që po ndodhin në fushën e sportit, kështu që në vlerësimin tim është i nevojshëm, ndërsa i diskutueshëm dhe që mund të hiqet është paragrafi i fundit, nëse nuk duam të diskriminojmë veten në raport me ndeshjet ndërkombëtare.

Ulsi Manja - Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Në nenin 48 parashikohen si sjellje të palejuara: gjuajtja e sendeve në terrenin sportiv të lojës, ose në tribunat e tifozëve, parashikohet edhe hyrja...

Fidel Ylli - Nxijtja e urrejtjes që mund të sjellë deri në dhunë apo sulme fizike, dëmtimi i mjedisit sportiv, të gjitha janë të parashikuara në ligj...

Elena Xhina – Por këto janë sjellje të palejuara, ndërsa në nenin 55 janë kundërvajtjet administrative dhe nuk parashikohet shprehimisht që këto sjellje të palejuara të nenit 48 janë kundërvajtje dhe dënohen me gjobë.

Për sa i përket mbivendosjes që diskutoi zonja Lika, nuk jemi para atij fakti. Unë do të thosha këtë gjë: meqenëse kërkon ashpërsim të masave të dënimit, le ta bëjnë te paragrafi i dytë: “Nga kjo vepër penale ka ardhur zhvillimi normal i aktivitetit” dhe t’i ashpërsojë masat e dënimit. Jam dakord me këtë gjë.

Për sa i përket paragrafit të parë, do të insistoja ta linim kundërvajtje dhe ta dënonim me gjobë, se nuk mundet ta dënojmë direkt me burgim vetëm hyrjen në fushën e lojës.

Ulsi Manja - Zonja, Xhina, që të jemi korrektë se në këtë komision kanë kaluar...

Kjo është e 28-ta apo 29-ta herë, që është ndërhyrë në Kodin Penal, është ndërhyrë edhe 27 herë të tjera dhe nuk e kemi herën e parë që po e bëjmë.

Neni 274 /“b” është shumë i qartë në variantin siç e kanë sjellë propozuesit.

Edhe unë jam dakord që të mos diskriminojmë veten dhe të ndajmë ndeshjet kombëtare nga ato ndërkombëtare, sepse qëllimi i dispozitës është të mbrojmë siç duhet veprimtarinë sportive dhe ambientet sportive, por diskutimi është tërësisht juridik, ajo që thotë kolegja Hysi.

“Kur më parë janë marrë masa administrative dhe kur nuk përbën kundërvajtje administrative, ndëshkohet penalisht”. Futja e dy fjalëve të tilla, zgjidh situatën. Unë personalisht nuk jam për ta copëtuar dispozitën, se del jashtë qëllimit për të cilin propozuesit e kanë sjellë.

Kemi rënë dakord që do të mbrojmë... vijat e bardha, janë vijat e kuqe, që nuk do të shkelen nga askush, sepse njerëzit në stadione shkojnë për qejf, për të parë ndeshjen, për të kaluar kohën e lirë, për adrenalinë dhe nuk shkojnë as për të gjuajtur nga shkallët e stadiumit, as për të sharë njëri-tjetrin. Neni 274/“b” pikërisht këtë ka thënë “zotëri, po shkoje në stadium

me idenë që të përlesh shishen me benzinë e ta hedhësh në fushë, nuk ke për të shkelur më në stadium, por do të shkosh në burg”. Por jo ta fillojmë me gjobë, pastaj t’i shtojmë edhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë jam për variantin: “Hedhja e sendeve të forta në fushën e lojës, ose mbi masën e njerëzve, mbajtja apo përdorimi i lëndëve piroteknike, fishekzjarrëve, flakadanëve gjatë zhvillimit të një aktiviteti sportiv, kur nuk përbën kundërvajtje administrative (formulimin e gjejnë prokurorët), dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 3 vjet”. Këtu duhet të mbyllet problemi i kësaj pune. Të mos bëjmë lojëra fjalësh tani!

Po, zoti Luli.

(Diskutim pa mikrofon)

Kujtim Luli – Fjala që duhet shtuar në vlerësimin tim, është: “kur është marrë më parë masë administrative”, te paragrafi i parë.

(Diskutim pa mikrofon)

Ulsi Manja - A ka mundësi, zoti Luli dhe zonja Xhina, që neni 279/”b” të qëndrojë me dy paragrafë? Mos ma ndani në 3 paragrafë.

Elena Xhina – Zoti kryetar, edhe për efekt të punës që kemi bërë, ne nuk kemi ndryshuar asgjë të hedhja e sendeve të forta, është e njëjta dispozitë që keni bërë edhe ju. Nuk e kuptoj diskutimin, se kemi tekstin përpara dhe nuk kemi nevojë të shtojmë “as kur është marrë masë para” dhe as “kur është kundërvajtje”, sepse këtu është me burgim dhe nuk ka lidhje me gjobën. Kështu që është shumë në rregull siç është.

Ulsi Manja - Ju keni thënë “hyrja në fushën e lojës dënohet me gjobë”.

Elena Xhina – Jemi duke folur për hedhje. Të lutem, që të jemi të qartë për këtë që po themi!

Mund të them diçka përfundimisht?

Ulsi Manja - Zonja Xhina, duhet të ma përmbledhni dispozitën, të lutem! Pse e keni nxjerrë “hyrjen në fushë” në paragrafin e parë?

Elena Xhina – Sepse kemi menduar që hyrja përbënte kundërvajtje. Hyrja nuk është njëlloj me gjuajtjen, zoti kryetar. Jemi duke folur për gjuajtjen në këtë moment. Ne kemi menduar që hyrja nuk ka të njëjtën rrezikshmëri me gjuajtjen. Pra, fjalën “hedhje” e kemi lënë siç e keni propozuar. Ndryshimi i vetëm është se hyrja në fushën e lojës është quajtur kundërvajtje administrative dhe, kur ka sjellë pasojë pengimin e aktivitetit, është dënuar më tepër. Këtu kemi bërë ndryshimin ne.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Lexoje përfundimisht!

Elena Xhina – “Hyrja në fushën e lojës gjatë kohës së zhvillimit të aktivitetit sportiv nga persona të paautorizuar përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë. Kur nga kjo vepër ka ardhur pengimi i zhvillimit normal të aktivitetit sportiv, dënohet me gjobë ose me burgim deri në 3 muaj. Hedhja e sendeve të forta në fushën e lojës ose mbi masën e njerëzve, mbajtja apo përdorimi i lëndëve piroteknike, fishekzjarrëve, flakadanëve gjatë zhvillimit të një aktiviteti sportiv, kur nuk përbën kundërvajtje administrative, dënohet me burgim nga 6 muaj deri në 3 vjet”.

Ulsi Manja - Pra, me këtë riformulim keni bërë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk është ashtu!

Po ju marr një shembull praktik: “Ka filluar ndeshja, ra bilbili. Hyri një person në fushën e lojës, që mund të jetë dëndur në alkool dhe i duket fusha bosh...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, se do të ndëshkohen njerëz me këtë dispozitë!

E kap ai ligji i Fidelit, i sportit, e nxjerr, ulet prapë atje dhe i thuhet: “Mos lëviz!”. Ky njeri, edhe po nuk e ndëshkove fare si kundërvajtje penale, është i padëmshëm, është sportiv madje.

Qëllimi i dispozitës ka qenë kur hyrja në fushën e lojës në mënyrë të dhunshme pengon zhvillimin normal të aktivitetit sportiv.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Luli, unë jam që ky personi që thotë zoti Fino, hyn për qejf në stadium, madje ndonjëherë e keni parë që në stadione përcillen edhe mesazhe, në fushën e lojës futen edhe grupe të caktuara interesi, të cilat përcjellin mesazhe kundër dhunës, kundër bulizmit e të tjerë, pra, kur thotë zoti Lita, ndonjëherë futet një person i veshur me një bluzë për reklamë atje, sepse një stadium me 70 mijë tifozë...

Këta persona nuk janë të dëmshëm për sportin, por as këta nuk kanë pse hyjnë në stadium.

Pyetja e fundit është, në variantin që e propozoi zonja Xhina, a zgjidhet situata?

Po, zoti Luli.

Kujtim Luli – Dua të bëj një plotësim: “Hyrja në fushën e lojës gjatë kohës së zhvillimit të aktivitetit sportiv nga persona të paautorizuar, që shkakton pengimin e zhvillimit normal të aktivitetit sportiv, dënohet me burgim” si ta vlerësoni, pastaj...

(Diskutime pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Po, zoti Lita.

Korab Lita - Në funksion të kësaj që po diskutojmë tani, por nëse hyn në fushën e lojës një kafshë shtëpiake, të cilën mund ta ketë marrë në stadium...

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ka shkuar në stadium së bashku me një kafshë shtëpiake, një qen, thotë zoti Lita, dhe hyn qeni në stadium?

(Diskutime pa mikrofon)

Korab Lita – Në këtë mënyrë pengohet loja.

Ulsi Manja – Kjo është te neni 207.

Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Unë mendoj se zoti Braho dhe zoti Fino ngritën me të drejtë një shqetësim të arsyeshëm që lidhet me finalen e Champions League. Nëse në fushë hyn një person që do të japë një mesazh politik, reklamë, toples e të tjera, se ajo fjala nuk lejohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Toples lejohet se është fjalë që nuk ekziston në fjalor, atëherë mua më duket pak e ekezagjeruar ta dënosh nga 1 deri në 3 vjet, por mendoj se kjo duhet riformuluar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

... e lexova, pra.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Gjoni!

Zoti Pratola a keni ndonjë mendim për këtë?

Gianluigi Pratola – Në ligjin italian nuk janë këto rregulla specifike dhe aty ka një rregull specifik, i cili nuk lejon që të shkojnë në stadium këta persona që kanë paraqitur sjellje që dënohen nga rregulli dhe nëse ata shkojnë në stadium, dënohen.

Sa i përket çështjes së parë, pse nuk duhet ta konsiderojmë si çështje rënduese dhunën në ndeshje?

(Diskutime pa mikrofon)

Në nenin 274/a nuk është vendosur si rrethanë cilësuese goditja apo vepra të tjera me radhë, sepse vetë paragrafi flet për rrethanat...

Ulsi Manja – Zoti Pratola i referohet nenit 274/a, të cilin ne e kaluam.

Faleminderit!

Zoti Ylli, dua një përgjigje për pyetjet e koleges Hysi, sepse në nenin 274/b ju keni propozuar shtimin e dy paragrafëve. Çfarë është sjellja e dukshme antisportive apo e dhunshme?

Fidel Ylli – Patjetër!

Sjellja e dhunshme nënkupton çdo veprim agresioni apo ndikim i padrejtë i ushtruar mbi një person nga zbatimi i forcës nëse nuk rezulton me lëndime trupore. Pra, ne kemi shtuar këtu një nen, i cili nuk është në propozimet e grupit, ku sjellje e dukshme antisportive apo e dhunshme, që synon të nxisë alarmin te tifozët, se sherri fillon nga tribuna pastaj zbret në fushë, nuk është si rrufe në qiell të pastër, prandaj ne mendojmë ta parandalojmë që nga tribuna atë që nxit sherrin, në mënyrë që të identifikohet. Pra, këtu kemi vënë gjobën, punë në komunitet deri në 3 vjet burg, por kjo varet nga nxitja apo situata e dhunshme që krijohet.

Kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim dhe cenon zhvillimin normal të aktivitetit sportiv, dënohet me burgim deri në 5 vjet. Unë po ju citoj, këto nuk janë shpikje, keni kodin penal hungarez, i cili është model, të cilët edhe pse i kanë stadiumet me kamera dhe me standarde europiane, shihni si e kanë të përcaktuar në se çfarë do të thotë sjellje e dhunshme, kur kryhet ajo dhe kur e nxisin tifozët.

Po të lexoni me vëmendje Kartën Europiane, të cilën e kemi ratifikuar në parlament, janë të gjitha agjencitë shtetërore ligjzbatuese që duhet ta parandalojnë dhunën, sepse duhet të ketë bashkëpunim ndërmjet Shërbimit Informativ Kombëtar, Policisë Kriminale, klubit, shoqatës së tifozëve, sepse tifozët e dhunshëm dihet se kush janë, pasi vetë klubi i merr nga një qytet në një qytet tjetër. Në rast se këta tifozë janë dënuar në bazë të ligjit të sportit me gjobë për të mos hyrë në stadium, ne nuk shkojmë deri te kjo pikë, prandaj po ju them se kjo punë kërkon një bashkëpunim institucional të shtetit dhe të policisë.

Në ligjin për sportin ne e kemi përcaktuar që përgjegjësi për mbarëvajtjen e aktiviteteve sportive është Policia e Shtetit, prandaj policia nuk duhet të shmanget, duke thënë: “Unë nuk futem në fushë”. Dhuna nuk fillon në stadium, ajo fillon para se të futesh në stadium, duke identifikuar të gjithë tifozët për të parandaluar dhunën, pasi ne nuk kemi ndër mend t’i fusim të gjithë njerëzit në burg. Hyri një tifoz me bluzë në stadium se kërkon të takojë Mesin ne nuk mund ta dënojmë me 5 vjet burg, por duhet që shteti të funksionojë me rregulla dhe me parandalimin e dhunës që të mos shkojmë deri këtu.

Udhëzuesi më i mirë yni, që duam të shkojmë në Europë, është Karta Europiane. Merreni dhe lexojeni se si e ka të përcaktuar dhunën, e kemi ratifikuar këtu në parlament, madje kam këtu edhe letrën që ka firmosur Kryeministri Rama që në vitin 2016, Karta Europiane e dhunës në sport.

Në të janë të përcaktuara të gjitha situatat se si duhet të veprojmë ne me këtë konventë dhe cili është qëllimi i kësaj konvente? Çfarë ofron qasja e integruar? Kjo është më kryesorja. Prandaj jemi në këtë pikë, se kjo nuk zbatohet. Nëse zbatohet Karta Europiane, nuk do të ketë dhunë në sport. Ka shumë vende europiane që e kanë pasur këtë dhunë para nesh dhe i kanë

kthyer stadiumet në festë. Pse? Se i gjithë shteti është në funksion dhe në interes të futbollit dhe jo vetëm klubi.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Ylli!

Fjalën e ka zonja Mara.

Aurora Mara – Faleminderit, kryetar!

Dua t’ju theksoj se të gjithë jemi dakord për një ridimensionim të rregullave në fushën e sportit dhe për një disiplinë të caktuar për t’i mbrojtur të gjithë pjesëmarrësit në këtë veprimtari.

Sa i takon nenit 274/b mendoj se është i saktë, sepse në momentin që hyrja në fushën e lojës nuk e pengon aktivitetin, e kemi lënë që të dënohet me gjobë, por kur nga kjo vepër ka ardhur pengimi i zhvillimit normal të aktivitetit fizik, e kemi dënuar me burgim deri në 3 muaj.

Pra, në vend që të lëmë vetëm pjesën që hyre në fushën e lojës dhe e pengove aktivitetin...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, që të më kuptoni, duhet të më dëgjoni deri në fund!

Pra, në momentin që hyn në fushën e lojës dënohesh, por pengon aktivitetin e zhvillimit normal të lojës, dënohesh me burgim deri në 3 muaj, por nuk ishte e përcaktuar hyrja në fushën e lojës, pra e pengon ose nuk e pengon aktivitetin. Kemi futur edhe momentin kur hyn në fushën e lojës, por nuk pengon aktivitetin, sepse mund të hysh edhe rastësisht ose për një gabim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Eshtë e parashikuar kjo.

Po si t’ia bëjmë, të mos i ndajmë këto dy veprime?

Ulsi Manja - Zoti Ylli, ti je me variantin e propozuesve. Po atëherë pse bën debat?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shtesën nuk e kemi futur, sepse kemi problem me togfjalëshin “sjellje antisportive”, sepse po të futet kjo dispozitë, do të shkojë në praktikë dhe prokurorët që do t’i marrin këto çështje do ta kenë problem të vlerësojnë sjelljen antisportive.

Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Kur unë ngrita pyetje për propozimin e ardhur nga Komisioni i Medies lidhur me atë çfarë quhet “sjellje e dukshme antisportive dhe e dhunshme”, kam parasysh që të gjitha propozimet që kanë sjellë kolegët bëjnë fjalë për sjellje të dhunshme që nga goditja, hedhja e mjeteve piroteknike e të tjera. Neni 48, i ligjit nr. 79/2017 “Për sportin” bën fjalë për ndalimin e provokimeve dhe i sjelljeve të palejuara, tek të cilat futet gjuajtja me sende të forta, hyrja e

paautorizuar në hapësirat zyrtare, shfaqja e materialeve propaganduese që fyejnë ndjenjën kombëtare. Pra, ky nen i ka sqaruar të gjitha provokimet dhe sjelljet e palejuara, prandaj është mirë të përdorim të njëjtën terminologji.

Së dyti, bie në sy që në nenin 55 të ligjit “Për sportin” ka një paragraf të dytë ku thuhet: “Shkelja e pikës 3 të nenit 5 të këtij ligji përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose burg deri në 2 vjet”. Po t’i referohemi pikës 3 të nenit 5 është pikërisht shqetësimi që unë ngrita që në fillim, është diskriminimi në veprimtaritë sportive për shkaqe të bindjeve politike fetare, racës etnisë, gjuhës, gjinisë, orientimit seksual, gjendjes ekonomike dhe shoqërore.

Të nderuar kolegë, kemi një vendim të Gjykatës Kushtetuese, unë nuk e dija se ligji “Për sportin” nuk ka kaluar në komisionin tonë, sepse nuk do ta lejonim të kishte dënim penal në një ligj që miratohet me shumicë të thjeshtë. Meqenëse ne po ndërhyjmë në Kodin Penal është momenti për ta rregulluar dhe për t’i thënë jo gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit për çdo lloj motivi dhe për ta transpozuar këtë dispozitë që është në një ligji, thjeshtë te Kodi Penal.

Nga ana tjetër, nëse merret në konsideratë kjo gjë duhet të kemi parasysh që në Kod Penal ne kemi një vepër penale që është në nenet 265 dhe 266, të cilët e lidhin kryerjen e veprës penale me ardhjen e pasojës, pra jo vetëm me faktin që ka urrejtje. Sipas mendimit tim që në momentin pa ardhur pasoja nëse dikush diskriminohet për shkak të etnisë kombësisë orientimit seksual e të tjera, duhet ndëshkuar.

Fidel Ylli- Ligji i sportit para se të votohej në parlament ka shkuar në 7 ministri, dhe një nga këto ministri përgjegjëse për të parë gjuhën juridike si është krijuar ligji ka qenë edhe Ministria e Drejtësisë.

Elena Xhina- Lidhur me diskutimin e zonjës Hysi në nenin 265 nuk shoh të kërkohej pasojë, është thjesht nxitja e urrejtjeve dhe e grindjeve për shkak të racës etnisë fesë ose orientimit seksual, si edhe përgatitja përhapja ose ruajtja me qëllim përhapjen e mbishkrimeve me përmbajtje të tilla”. Pra, nuk ka pasojë. Kjo e kryer me çdo mjet ose formë ka burgim nga 2 deri në 10 vjet. Unë mendoj se do të bëhej një mbivendosje prandaj nuk e shoh të nevojshme. Për sa kohë që parashikohet si figurë në Kodin Penal nuk ka nevojë ta parashikojmë specifikisht, sepse jemi duke punuar po në Kodin Penal.

Ulsi Manja – Për procedurë, zoti Gjoni, se e shoh që m’u dashkan leksione edhe nga sporti.

Ralf Gjoni- Zoti Manja, sikur të kalonim kaq kohë për të siguruar jetën e qytetarëve shqiptarë nëpër rrugët e pasigurta të Shqipërisë sa ç’po kalojmë me këtë projektligjin për dhunën në sporte, do të ishte fantastike. Unë mendoj se parlamentet nuk kanë nevojë të marrin

mendimin e 7 ose 17 ministrive, sepse nuk na jep dot mend neve ekzekutivi. Ekzekutivi është atje të bëjë punën e vet, por parlamenti vendos.

Unë mendoj se parlamenti duhet të flasë me votë. Ta hedhim në votim, zoti kryetar, ta mbarojmë këtë punë dhe secili të japë mendimin e vet.

Ulsi Manja – Në fakt, ke të drejtë, zoti Gjoni. Në fakt, tani unë duhej të kisha kaluar 3 paketa të Kodit Penal, por duke qenë se ndryshimet në Kodin Penal kanë impakt të madh për qytetarët nesër, jam i detyruar të harxhoj shumë kohë e shumë mbledhje për të kaluar një dispozitë. Këto janë dispozita të Kodit Penal që referojnë në ligje të tjera, unë jam i detyruar të mos i votoj sot dhe ta lë të hapur, sepse shoh që me ligjin për sportin nuk janë harmonizuar të dyja këto dispozita. Pra, te ligji “Për sportin”, zonja Hysi hedh pyet se cila është në këto dy vepra? Kodi Penal jep edhe veprat penale latente që ndëshkohen vetëm mjafton konstatimi, siç është armëmbajtja pa leje.

Jo, nuk e votoj dot zonja Xhina, sepse, nëse këto dy paragrafë që propozon janë shtesë, janë rishtas, edhe sjellja e dukshme antisportive edhe rezistenca e dhunshme do të duhet të thuhet nga relatorja që nuk i marrim në konsideratë propozimet e komisionit.

Pra, te neni 274/b hidhet në votim propozimi që ju keni riformuluar dhe nuk marrim në konsideratë sugjerimet e Komisionit të Edukimit dhe Sportit për një ose dy arsye.

Elena Xhina – Faleminderit!

Lidhur me diskutimin që bëri zoti Ylli lidhur me shtesat në nenin që ne jemi duke diskutuar së pari, janë shqetësimet që ngriti zonja Hysi që terminologjia e përdorur bën që dispozita subjektive nuk gjen njëtrajshmëri në leximin e saj aq më tepër edhe masat e dënimit të vendosura nuk janë fare në përputhje me pjesën e përgjithshme të Kodit Penal, kështu që unë mendoj se këto shqetësime të ngritura nga zoti Ylli e gjejnë lidhjen e tyre në Kodin Penal në përgjithësi. Pra, unë mendoj se nuk duhen marrë në konsideratë lidhur në këtë moment me këtë dispozitë.

Unë propozoj të hidhet në votim dispozita siç e kemi riformuluar në grupin e punës dhe që unë e kam paraqitur deputetëve për miratim.

Ulsi Manja- Relatorja thotë që të dy nenet që propozohen pra, nenet 274/b dhe 274/c gjejnë zgjidhje në nenet 265 dhe 266 të Kodit Penal.

Pra, edhe relatorja edhe zoti Luli thonë që këto dy situata janë të zgjidhura në Kodin Penal me nenet 265 dhe 266 të Kodit Penal.

Kalojmë te neni 16.

Elena Xhina – Neni 16 sjell një ndryshim në dispozitën që i përket nenit 278 të Kodit Penal. Nga grupi i punës është parë me vend propozimi për riformulimin e paragrafit të dytë,

gjë për të cilën kemi pasur në konsideratë vendimin nr. 9, datë 26.02.2016 të Gjykatës Kushtetuese.

Riformulimi ynë, për sa i përket paragrafit të dytë, është: “Po kjo vepër, kur kryhet më shumë se një herë ose në sasi të mëdha, dënohet me burgim nga shtatë vjet deri në pesëmbëdhjetë vjet”.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zoti Luli.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, në nenin 278, paragrafi i parë, ka një ndryshim në përmbajtjen që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, riformulimi i paragrafit të dytë. Pra, ju propozoni që paragrafi i dytë të ketë këtë përmbajtje: “Po kjo vepër, kur kryhet më shumë se një herë ose kur ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga shtatë vjet deri në pesëmbëdhjetë vjet”, ndërkohë që ju propozoni formulimin: “Po kjo vepër, kur kryhet më shumë se një herë ose në sasi të mëdha, dënohet me burgim nga shtatë vjet deri në pesëmbëdhjetë vjet”.

(Deputetja Hysi flet pa mikrofon.)

Ju lutem!

Elena Xhina – Ne kemi hequr shprehjen “pasoja të rënda”, duke iu referuar vendimit nr. 9, datë 26.02.2016, të Gjykatës Kushtetuese, në faqen 21 të tij Gjykata shprehet: “Shprehja “pasoja të rënda” është e paqartë dhe lë vend për interpretime të ndryshme në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike”, që i përket pikërisht ndryshimit të kësaj dispozite që u bë në atë kohë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për sa i përket shprehjes “sasi të mëdha”, është tashmë e njohur te kjo dispozitë, përsëritet disa herë, si dhe ka vendime unifikuese që përcaktojnë rastet kur janë sasitë e mëdha. Kështu, meqenëse si rast ishte i pazgjidhur, nuk ishte vendosur “sasi të mëdha”, menduam të gjejë vend dhe të zgjidhet në këtë rast.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zonja Mara, sepse kjo është tërësisht teknike.

Aurora Mara – Edhe unë e kam teknik riformulimin.

Atëherë, propozoj të hiqet si pjesa “pasoja të rënda”, siç ishte në formulimin e parë, ashtu edhe togfjalëshi “sasi të mëdha”, përderisa lindin shumë probleme pastaj se si do të evidentohen sasia ose pasojat e rënda.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në momentin që mbajtja e armëve shpërthyesë është e cilësuar si vepër penale, atëherë vjen formulimi: “Po kjo vepër penale, kur kryhet më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë vjet deri në pesëmbëdhjetë vjet”. Pastaj është shumë e qartë, për mendimin tim, në qoftë se do të heqim pjesën “sasi të mëdha”, për ta evidentuar...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po, zoti Luli.

Kujtim Luli – Ashtu siç u shpreh edhe relatorja, problemet e këtij riformulimi ose kësaj shtese lidhen me vendimin nr. 9 të vitit 2016 të Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar dy paragrafë të nenit të mëparshëm, por që janë ndryshuar dhe janë plotësuar me ligjet në vijim.

Ne menduam që, meqenëse ligjvënësi do të shtojë rrethanat cilësuese për paragrafin e parë, rrethana cilësuese të pranueshme janë kur vepra kryhet më shumë se një herë dhe në sasi të mëdha... Pse edhe në sasi të mëdha? Sepse paragrafi i shtatë i nenit në fuqi thotë: “Kur kjo vepër, e parashikuar nga paragrafi i pestë i këtij neni, kryhet në sasi të mëdha dhe në bashkëpunim më shumë se një herë...”, pra është rrethanë cilësuese të paragrafi i shtatë i nenit në fuqi për prodhimin e armës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zonja Mara, është e zgjidhur. Megjithatë, mund ta thoni mendimin tuaj.

Aurora Mara – Mendimi është që, kur një vepër ripërsëritet si në sasi të mëdha, si në sasi të vogla, është e njëjta gjë, është përsëritëse.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për mua, nuk ka sens.

Ulsi Manja – Pra, paragrafi i dytë i nenit 278 merr në konsideratë dy situata krejtësisht të ndryshme, sepse përdor lidhëzën “ose”, pra “përsëritjen” ose “në sasi të mëdha”. Janë dy rrethana të veçanta.

Kush është dakord me nenin 16, me riformulimin e bërë në paragrafin e dytë? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Vijmë te neni 274/b. Zonja Xhina, ju lutem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, te neni 274/b, ku titulli i dispozitës është “Veprimet e dhunshme në aktivitetet sportive”, relatorja propozon: “Hyrja në fushën e lojës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo, do ta votoj unë tani!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

“Hyrja në fushën e lojës gjatë kohës së zhvillimit të aktivitetit sportiv nga persona të paautorizuar përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë”.

Paragrafi i dytë: “Kur nga kjo vepër ka ardhur pengimi i zhvillimit normal të aktivitetit sportiv, dënohet me gjobë ose burgim deri në tre muaj”.

“Hedhja e sendeve të forta në fushën e lojës ose mbi masën e njerëzve, përdorimi i lëndëve piroteknike, fishekzjarrëve, flakadanëve gjatë zhvillimit të një aktiviteti sportiv dënohet me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet.

Paragrafi i fundit, që bën diferencimin ndërmjet aktivitetit kombëtar dhe ndërkombëtar, të hiqet”. Ky është neni 274/b që propozon relatorja.

Ndërsa dy propozimet e tjera, të ardhura nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, për të pasur një paragraf shtesë në nenin 274/b në lidhje me sjelljet e dukshme antisportive dhe të dhunshme, si dhe për të pasur një nen të ri 274/c me këtë përmbajtje: “Çdo sjellje e rezistencës së dhunshme ose frikësuese nga personat ndaj veprimtarive të personelit të sigurisë për mbajtjen e rendit publik përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë, me punë, me shërbim të komunitetit ose me dy vjet burgim”, sipas relatores dhe zotit Luli, si përfaqësues i Prokurorisë së Përgjithshme, këto gjejnë zbatim të plotë në nenet 265 dhe 266 të Kodit Penal. Pra, gëzojnë mbrojtje juridiko-penale të posaçme.

Kush është dakord me nenin 274/b, sipas riformulimit të bërë nga relatorja? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 17, ku propozohet që pas nenit 278/a të shtohet një nen 278/b me përmbajtjen, si më poshtë.

Fjalën e ka relatorja.

Elena Xhina – Kjo dispozitë ka mbetur e njëjtë, siç është propozuar nga deputetët nismëtarë, vetëm kemi propozuar të hiqet fjala “nukleare”, pasi është e njëjtë me fjalën “bërthamore”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është i vetmi ndryshim.

Ulsi Manja – Dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord me nenin 17, sipas sugjerimit të zonjës Xhina? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 18, që kërkon të ndryshojë nenin 282.

Elena Xhina – Për sa i përket nenit 18, që kërkon të ndryshojë nenin 282, sugjerojmë vetëm që në propozimin e bërë nga deputetët të hiqet termi “substancë”, pasi nuk është në dispozitën aktuale të Kodit Penal dhe të qëndrojë siç është.

Ulsi Manja – Biem dakord?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 18, që ndryshon nenin 282 të Kodit Penal.

Kalojmë te neni 19, ku kërkohet të bëhen disa ndryshime në nenin 282/a.

Elena Xhina – Edhe për nenin 19 qëndrojnë të njëjtat komente. Duhet hequr vetëm termi “substancë”.

Ulsi Manja – Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 20.

Këtu kemi filluar me paketën e sigurisë ushqimore. Dua të informoj kolegët, relatoren, por edhe të pranishmit, që për këtë paketë kemi pasur shumë komente dhe sugjerime nga shoqata prodhuesish, shoqata konsumatorësh dhe nga rrjete supermarketesh, të cilët kërkojnë që në formulimet e dispozitave që kanë të bëjnë me paketën e sigurisë ushqimore, të penalizohen ata që janë ilegalë në treg dhe ata që ushtrojnë këtë veprimtari edhe pasi janë ndëshkuar në rrugë administrative nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Qëllimi i kësaj pakete nuk është të ndëshkojë prodhuesit dhe tregtarët e ndershëm, aq më pak konsumatorët, por mbrojtja e konsumatorit.

Zonja Xhina, shpresoj t’i keni qartësuar këto dispozita, që të paktën në formulimet e përmbajtjes konkrete, kur të vijmë nën për nën, të jetë arritur qëllimi për të cilin i kemi depozituar.

Fillojmë me nenin 288.

Prodhimi dhe shitja e ushqimeve dhe lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin.

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Siç e thatë edhe ju, kjo dispozitë është diskutuar shumë gjatë dhe ne në grup pune kemi pasur shumë diskutime. Jemi përpjekur që në riformulim të marrim në konsideratë shqetësimet e ngritura nga shoqatat Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë dhe Bashkimi Tregtar i Prodhuesve, pasi të dyja kanë dhënë shumë kontribut, por edhe nga Ministria e Bujqësisë dhe aktorë të tjerë të interesuar.

Ne kemi bërë një riformulim duke futur që në titull disa elemente të veprës penale, si importimi, prodhimi, shitja dhe ruajtja e ushqimeve të rrezikshme për shëndetin ose jetën e njerëzve dhe jemi përpjekur që nëpërmjet pasojës së parashikuar të mos penalizojmë çdo rast apo veprimtari të prodhuesve apo të subjekteve të tjera që parashikon ligji: “Importimi, prodhimi, ruajtja, shitja apo vendosja në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër i ushqimeve ose futja në prodhimin e artikujve ushqimorë, e kimikateve, materialeve apo lëndëve shtesë, që rrezikojnë shëndetin ose jetën e njerëzve, në shkelje të kërkesave të legjislationit të posaçëm, kur është marrë më parë masë administrative, dënohet me burgim deri në 3 vjet. Kur nga kjo vepër penale ka ardhur vdekje ose dëmtim i rëndë i shëndetit të personit, dënohet me burgim nga 3-10 vjet. Kur nga vepra është shkaktuar vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të disa personave dënohet me burgim nga 10-25 vjet”. Propozoj që paragrafi i fundit për pakujdesinë, që ne kemi parashikuar, të mos merret në konsideratë, por të ngelet dispozita aktuale.

Fjalët “pijet dhe lëndët e tjera ushqimore” janë hequr pasi kategorizohen të gjitha brenda ushqimeve. Gjithashtu, nga propozimi janë hequr edhe barnat e rrezikshme pasi trajnohen në nenin 284/d të Kodit Penal, si dhe është bërë një ndryshim në masat e dënimit duke parë rrezikshmërinë e veprave. Kështu që, ju ftoj ta diskutojmë dhe më pas ta kalojmë në votim.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zoti Luli.

Kujtim Luli – Mendimi që kemi sjellë institucionalisht si prokurori është të hiqet togfjalëshi “kur është marrë më parë masë administrative”. Siç shikohet, në hierarkinë e kësaj norme janë parashikuar dënime kur si pasojë e kësaj vepre ka ardhur dëmtimi i rëndë i shëndetit. Nëse do të kishte një paragraf të parë, kur nuk është marrë më parë masë administrative, nuk zbatohet paragrafi i dytë, i tretë, i katërt për rastet kur sjellin pasoja të rënda, deri edhe vdekjen nga shkelja e rregullave që parashikon paragrafi i parë i këtij neni.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Luli!

Zonja Xhina, kam unë një pyetje.

Çfarë zgjidh duke shtuar në dispozitë “kur më parë është marrë masë administrative”, kur ju thoni “importimi, prodhimi e të tjera, në shkelje të kërkesave të legjislationit të posaçëm?”

Pra, ju po thoni që ka një legjislation të posaçëm në këtë fushë dhe nëse shkelet ky legjislation i posaçëm, t’i do të ndëshkohesh penalisht. Pra, mos ndoshta shtimi i togfjalëshit “kur më parë është marrë masë administrative” është fakultativ?

Elena Xhina – Zoti kryetar, ky togfjalësh është vendosur nga ana jonë duke pasur në konsideratë pretendimet e të gjitha grupeve të interesit.

Pra, nga të gjitha grupet e interesit kërkohej që subjekti të ndëshkohej njëherë administrativisht dhe më pas të konsiderohej vepër penale.

Megjithatë, unë ia lë për diskutim komisionit. Ne kemi marrë në konsideratë pretendimet e tyre dhe jemi përpjekur ta gjejmë veten te kjo dispozitë.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zonja Mara.

Aurora Mara – Faleminderit, kryetar!

Koncepti është që t'i forcojmë masat për sigurinë ushqimore.

Nuk jam dakord me pjesën “kur është marrë më parë masë administrative”, sepse pastaj del *nonsense* forcimi i masave. Në momentin që ne i lëmë alternativën që të merret më parë masë administrative, atëherë çfarë kuptimi ka që ta dënojmë më pas.

Nëse ne jemi të një mendjeje, mendoj se duhen marrë masa shumë të forta për importimin, prodhimin, shitjen dhe ruajtjen e ushqimeve të rrezikshme për shëndetin dhe jetën e njerëit. “Kur është marrë më parë masë administrative”, për mendimin tim duhet hequr kategorikisht.

E dyta, pjesën “kur nga vepra është shkaktuar vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të disa personave, dënohet me burgim nga ...”, unë mendoj ta heqim, sepse në momentin që ne parashikojmë se nga kjo vepër ka ardhur vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të personit, dënohet me burgim nga 3-10 vjet, ose të ndryshojmë masën...

Pjesën “kur nga vepra është shkaktuar vdekja ose dëmtimi i rëndë të disa personave” duket sikur ne e fusim në një kornizë.

Më duket *nonsense*, zoti kryetar, që ne të parashikojmë me ligj vdekjen e një personi apo të dhjetë personave dhe të vëmë një kornizë mbi dënimin e atij personi që nëse ka vrarë një apo nëse ka vrarë pesë apo ka ardhur vdekja e dhjetë personave.

Në momentin që ne parashikojmë që “kur nga kjo vepër penale ka ardhur vdekja ose dëmtimi i rëndë i shëndetit të personit, dënohet me burgim nga kaq deri në kaq vite dhe jam gjithmonë për rëndesë të dënimit.

Ulsi Manja – Më fal që po ju ndërhyj, sepse mund të ndodhë, natyra e këtyre veprave është e tillë, që pasojat që shkaktjnë ndryshojnë nga krimet e tjera që ka Kodi Penal, flas për krimet kundër jetës dhe shëndetit të personit, sepse mund të ndodhë që në një dasmë i merr të gjitha ushqimet e skaduar dhe ushqen 500 dasmorë dhe i çon të gjithë për..

Aurora Mara – Pikërisht këtë doja të sqaroja. Atëherë, nëse jemi në një dasmë dhe është shkaktuar vdekja e 30 vetave, ne nuk mund të vëmë një kornizë dënimi me 10-25 vjet burgim, sepse janë 30 vetë dhe më duket *non sens* ky dënim që të jetë njësoj sikur të vrasësh 1,2, 5 ose 10 veta.

Kujtim Luli - Në aspektin e teknikës legislative mund të parashikohet: “Kur ka shkaktuar plagosjen e rëndë dhe kur ka shkaktuar vdekjen e personit”, pa përmendur “të disa”. Nëse janë disa persona, dënimi do të jetë për aq persona sa kanë ardhur pasojat. Kjo është zgjidhja, por, nëse nuk e parashikojmë...

Ulsi Manja- Zoti Luli, unë kam një shqetësim tjetër. E thashë edhe në fillim kur hapa këtë paketë ligjesh, që të gjejë zgjidhje në këtë dispozitë dhe të mos lëmë hapësira abuzimi për t’u ndëshkuar prodhuesit e ndershëm dhe tregtarët e ndershëm, sepse kemi edhe një legjislacion të posaçëm dhe Autoritetin Kombëtar të Ushqimit, gjobat e të cilit janë të mëdha, sipas ligjit. Shqetësimi i kësaj kategorie njerëzish ka qenë që të ndajmë momentin kur vjen inspektori i AKU-së në biznes dhe të mos ketë dy alternativa, ose të ndëshkojë në rrugë administrative, ose të çojë për ndjekje penale. Ky ishte merakun e tyre.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Me të drejtë, zoti kryetar, e shtrojmë këtë diskutim, por unë dua t’i referohem ligjit nr. 9863, datë 28.01.20018, ligji për ushqimin, te kundërvajtjet administrative, “Çdo veprim që kryhet në kundërshtim me ligjin përbën kundërvajtje administrative, por nuk kërkon pasojë”. Ne te kjo dispozitë kemi vendosur një kusht kryesor për veprimet që rrezikojnë jetën dhe shëndetin e njerëzve, dhe ky është pikërisht ai filtri mbrojtës, sepse nuk mundet që çdo veprim, që është në shkelje të ligjit specifik, ta quajmë vepër penale.

Ulsi Manja – Jam shumë i qartë. Nëse si kriter ndarës për të ekzistuar kjo vepër penale ne marrim pasojën, atëherë unë jam dakord. Pra, t’u themi këtyre njerëzve që, nëse ti, zotëri, do të mbash 10 kilogramë oriz në dyqan tej afatit të skadencës, do të ndëshkohesh nga AKU-ja dhe, nëse nga ky veprim kanë ardhur pasoja, patjetër që do të ndëshkohesh penalisht.

Po, zoti Luli.

Kujtim Luli- Paragrafi është i qartë dhe i ndan si element të pasojës së veprës penale materialet apo lëndët shtesë që rrezikojnë shëndetin apo jetën e njerëzve. Pra, nëse të gjitha ato shkelje që parashikohen nuk janë me këtë lloj rreziku për shëndetin dhe jetën e njerëzve, këtë do ta verifikojë ekspertimi i materialit të lëndës ushqyese, që është gjendur në market, ai që ka ardhur nga importi, ose ai që përgatitet për të shkuar në transport...

Ulsi Manja – Meqenëse jemi në diskutim teknik dhe është një paketë e rëndësishme që unë kam të gjithë kohën e duhur për ta trajtuar si duhet, dua të jap një shembull, është ngritur

një kauzus konkret, kontratat e supermarketeve në Shqipëri, në Europë dhe botë që kanë me prodhuesit apo me furnitorët kryesorë në kontratat vjetore që ata lidhin, është parashikuar si detyrim i furnitorit tërheqja nga tregu i mallrave në afat skadence. Pra, është detyrim i palës që e furnizon. Tregtarët dhe rrjetet e supermarketeve thonë se, sipas kontratës, një muaj para aftit të skadencës apo tre muaj, furnitori ka detyrimin të vijë të tërheqë mbrapsht mallin, por mund të ndodhë që punonjësit në supermarkete, por edhe furnitorët të mos tërheqin nga magazina të gjithë sasinë, dhe këtu i referohen pakujdesisë, gabimit njerëzor, nuk i referohen dashjes ata. Thotë: mund të ndodhë që të nga 1 ton oriz, i cili do të tërhiqet, sepse ka mbushur afatin e skadencës, mund të harrohet një, që shitet dhe sjellë këto pasoja, që ne i kemi parashikuar në nenin 288. Ky rast, a mund të ndodhë? Pasoja, si do të vlerësohet në rastin konkret?

Kujtim Luli – Ky është problem fakti. Nuk po diskutojmë më problemin e ligjit dhe vetë dispozita, te varianti që ju keni, parashikon edhe kryerjen e kësaj vepre nga pakujdesia. Për shembull, nëse ka pasur një koli me 100 paketa, kanë ngelur 2 paketa nga ai punëtori, që i ka lënë nga pakujdesia në atë ambient, ai mban përgjegjësi direkt për atë.

Ulsi Manja - A mund ta fusim elementin e “dashjes”, mund të gjejmë një formulim të përshtatshëm, që të fusim “dashjen” te kjo dispozitë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fjalën e ka zonja Mara dhe më pas zonja Xhina.

Aurora Mara – Së pari, problemi i sigurisë ushqimore te ne, është jashtë mase i ekzagjeruar. Kështu që, nuk kemi pse të tolerojmë në këtë pikë. Duhet të marrim masa shumë të forta që të vendosim rregulla dhe të mos abuzohet më, sepse, zoti kryetar, bëhet fjalë për jetën e njeriut.

Ashtu siç e thashë, për pjesën e masave administrative nuk jam dakord, sepse në momentin që merr përsipër të importojë, të prodhojë, të ruajë dhe të shesë lëndë ushqimore, që janë komplet jashtë ligjit dhe jashtë parametrave, bota vlerëson dhe bën analiza specifike të pastërtisë së ushqimit dhe jo më të arrijë në prodhim të kundërligjshëm, të arrijë në lëndë ushqimore, që dëmtojnë shëndetin, dhe që sjellin si pasoje vdekjen.

Zoti kryetar, në momentin që do të marrim masa për këto lloj dhune ndaj sigurisë ushqimore, duhet të marrim masa të forta.

Në momentin që ne parashikojmë masa administrative, nuk ka kuptim dënimi me burg deri në 3 vjet. Për mua në momentin që ata marrin përsipër, si importuesi, si prodhuesi dhe si ai që e shet të merren me këtë gjë, atëherë të dënohen me burgim deri në 3 vjet, sepse me të vërtetë nuk sjell pasojën e vdekjes, por ai krimin e ka bërë, ka prodhuar, ka blerë, ka shitur dhe ka importuar. Domethënë, ai e ka dhunuar sigurinë ushqimore, pavarësisht se ka qenë fati i tij

që nuk ka vdekur njeri deri në atë moment, por nuk mund t'i tolerojmë të gjitha këto dhunime ndaj sigurisë ushqimore, apo jo?! Domethënë, ai ka bërë importimin, ka bërë prodhimin dhe çdo gjë e ka bërë me logjikë. Pra, ka blerë, ka shitur dhe ka importuar, në atë moment e ka ndihmuar Zoti, nuk ka vdekur njeri nga ato ushqime që ka shitur dhe që ka importuar, por krimin e ka bërë. Domethënë, ne duhet të ndalojmë fenomenin.

Ulsi Manja – Zonja Mara, por ky është legjislacioni i posaçëm që në dogana. Prandaj janë dispozita pak të komplikuar, sepse ligjet organike, legjislacioni i posaçëm, ka parashikuar edhe rastin se si veprohet kur importohet një sasi mishi ose pulash nga Brazili dhe Argjentina, sepse filtri i parë fillon që në doganë. Pra, që aty fillon AKU-ja dhe autoritetet doganore të vendosin standardet e respektimit të ligjit dhe këtu po flasim për produktin final, kur i ka kaluar të gjitha këto barrierat ligjore, dhe ka ardhur te vitrina e dyqanit. Ne tani po e marrim nga vitrina e dyqanit dhe magazina e supermarketit te konsumatori. Pra, ne duhet të mbrojmë këtë fashë, sepse, nëse do të konstatohet vepra penale që në momentin e zhdoganimit, patjetër që atje ka kontrabandë me mallra të tjera...

Zonja Xhina, një konsideratë të fundit, sepse do ta ndërpresim mbledhjen e komisionit për shkak të kuorumit dhe për t'i diskutuar më në detaje.

Elena Xhina – Dua të bëj një cilësim të vogël. Ne kemi thënë: “Importimi, prodhimi, ruajtja, shitja apo vendosja në qarkullim në ndonjë mënyrë tjetër e ushqimeve, ose futja në prodhimin e artikujve ushqimor të kimikateve materiale apo lëndëve shtesë”. Ne themi se rrezikojmë, por dua të them që kanë rrezikuar. Nëse do të themi që rrezikohen, do të ishte subjektive që prokurori mendon, nëse do ta rrezikojë apo jo kjo sasi, ndërsa kur themi se ka rrezikuar, tashmë ka ndodhur diçka. Kështu, ndoshta do të ishte më e mbrojtur me këtë shqetësim që ju e keni ngritur.

Ulsi Manja – Dakord.

Atëherë, do të ndërpresim mbledhjen e komisionit te neni 288 për të cilin e kemi bërë diskutimin dhe debatin, por do t'ju kërkoja, meqenëse jemi pothuajse në përfundim të shqyrtimit dhe miratimit nën për nen të kësaj pakete, duke marrë në konsideratë që kemi lënë të hapur nenin 207/c, pra nenin 10 të projektligjit, që ka të bëjë me braktisjen e kafshëve të shoqërimit.

Nenet që na kanë mbetur për t'i diskutuar në parim, do t'i rishohim edhe një herë. Unë do t'u sugjeroja relatorëve të jenë në kontakt me zotin Luli, me përfaqësuesit e Avokatit të Popullit dhe me ata të EURALIUS-it, patjetër edhe me përfaqësuesit e ministrive (ata të Ministrisë së Drejtësisë dhe ata të Ministrisë së Bujqësisë), sepse këto janë dispozita që për

sa kohë kemi mundësi t'i shohim në mënyrë të detajuar edhe me legjislacionin e posaçëm, të fokusohemi te kjo paketë.

Ju bëj me dije edhe një herë, sepse pothuajse për të gjitha nenet që kemi diskutuar deri tani, ka pasur propozime dhe variante alternative, madje edhe nga kolegët deputetë. Edhe javën që kaloi janë depozituar nisma për të ndërhyrë në nene të caktuara të Kodit Penal, siç ka edhe një propozim nga qeveria dhe nga Ministria e Brendshme.

Personalisht, i kam inkurajuar që sugjerimet, komentet, propozimet për këtë paketë të sjellin që të gjithë. Është vlerë dhe pasuri për debatin që po bëjmë, por në finale, personalisht, si kryetar i Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, por edhe në emër të kolegëve të mi, unë do t'i qëndroj strikt paketës së parë të depozituar, që është miratuar edhe nen për nen për mbrojtjen e kafshëve dhe ekzakhtësisht vetëm nismës së kolegëve deputetë.

Gjithçka tjetër që del jashtë këtyre krerëve dhe seksioneve, nuk do të jenë objekt i përfshirjes në këtë paketë. Pse? Shto ujë, shto miell dhe orekset që lindin rrugës, t'i depozitojnë aty ku është ngritur grupi i punës për hartimin e një Kodi të ri Penal, që do të marrë kohën e duhur, një vit, 6 muaj apo 2 vjet, por gjithsesi, unë i kam sugjeruar edhe relatores, edhe grupit të punës, pse jo, në këtë fazë të diskutimit çdo sugjerim, çdo projekt alternativ, çdo koment, çdo dispozitë që propozohet, është vlerë e shtuar që e pasuron debatin për hartimin e një Kodi të ri Penal që do ta kemi të gjatë, sepse nuk mendoj se i shërben paketës.

Po, sugjerimet që realisht kërkojnë të mbulojnë nga pikëpamja e mbrojtjes juridiko-penale një fushë që ne realisht nuk e kemi sot në Kodin Penal, edhe do ta diskutojmë, por jo gjëra që janë në Kodin Penal, që kërkohet të rregullohen. Ato janë objekt i grupit të punës.

Në të kundërt, nuk do t'i dalim deri në fund. Kemi zhvilluar shumë mbledhje të Komisionit të Ligjeve dhe po të vazhdojmë me këtë situatë, nuk do t'i dalim deri në fund paketës.

Edhe një herë, shumë faleminderit për prezencën në mbledhjen e sotme!

Ditë të mbarë!

Mbledhja e radhës do të njoftohet nga sekretaria.

MBYLLET MBLEDHJA

